

POLITIKAT
E MINERALIT

—

MINERAL
POLICIES



ZETA
Center for
Contemporary
Art in Tirana

SHËNIM
EDITORIAL
EDITORIAL
NOTE 6 — 14

PLAGËT
E BURIMIT 16 — 23

THE
WOUNDS 34 — 45

AT THE
SOURCE 64 — 69

98 — 101

HISTORIK
I SHKURTËR I
MINIERËS
SË BULQIZËS
A BRIEF HISTORY
OF THE
BULQIZA MINE
26 — 33

BISEDA
CONVERSATION 48 — 61

ÇDO GODITJE
PASON TJETRËN
EACH STRIKE
LEADS TO THE NEXT

70 — 97

FOTO-ALBUM
NGA QËNDRIMI
NË BULQIZË
PHOTO ALBUM
FROM THE STAY
IN BULQIZA

102 — 119

**MINE-
RAL**

— POLI
— CIES

SHËNIM EDITORIAL

EDITORIAL NOTE

“Kushtet janë ekstreme;
minatorët vriten përditë dhe janë
viktimat ato që fajësohen.”

*Elton Debreshi, minator dhe
(ish) drejtues i Bashkimit të
Minatorëve të Shqipërisë*

Ndonëse shpesh i përshkruar si një nga vendet më të varfra të Evropës – “bazuar tradicionalisht në bujqësi, blegtori dhe disa miniera”¹ — një vështrim më i thellë i gjendjes ekonomike të Shqipërisë zbulon se, në kundërshtim me supozimet e zakonshme, kjo tokë mesdhetare në Gadishullin Ballkanik nuk ka qenë edhe aq e varfër sa është hamendësuar. Si shpjegohet?

Në 2011, AEA (Albania Energy Association) publikoi një raport të përpiluar nga ekspertë mbi burimet minerale dhe aktivitetin minerar, i cili konfirmonte se “Shqipëria është një vend me burime të pasura minerale [...] krom, bakër, hekur-nikel dhe qymyr.”² Më tej, raporti deklaroi qartë se “eksplorimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i mineraleve përbëjnë një komponent-kyç të ekonomisë shqiptare, pasi industria minerare tradicionale ka shërbyer si një bazë solide për sektorin ekonomik

“Conditions are extreme, miners
are being killed every day and the
blame is put on the victims.”

*Elton Debreshi, a miner and
(former) leader of the United
Miners Union of Albania*

Though often described as one of the poorest countries in Europe — “traditionally based on agriculture and animal husbandry, with some mining”¹ — deeper insights into Albania’s state of economic affairs reveal that, contrary to common assumptions, this Mediterranean land on the Balkan Peninsula has not been as poor as usually assumed. How come?

In 2011, an expert report on mineral resources and mining activity was published by the AEA (Albania Energy Association) confirming that “Albania is a country with rich mineral resources [including] chrome, copper, iron-nickel and coal.”² Moreover, the report clearly states that “mineral exploration, exploitation, and processing constitute a key component of the Albanian economy, due to a traditional mining industry that has been a solid foundation to the country’s economic sector generating substantial revenues.”³

2

AEA – Albania Energy Association,
“Mineral Resources and Mining Activity in
Albania [Burimet minerale dhe veprimtaria
minerare në Shqipëri],” May 17, 2011 [17
Maj 2011].

<https://aea-al.org/mineral-resources-and-mining-activity-in-albania/>

3

Po aty.
Ibid.

1

Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania [Fjalori historik i Shqipërisë]*, 2nd edn. (Lanham: Scarecrow Press, 2010), 123.

të vendit duke gjeneruar të ardhura të konsiderueshme.”³

Historia e minierave në Shqipëri nis në fillim të shekullit të XX-të, kur “për shkak të burimeve të pasura minerale të vendit, gjeologu dhe paleontologu italian Paolo Vinassa de Regny krijoi hartën e parë gjeologjike të Shqipërisë së Veriut në vitin 1903, gjatë periudhës otomane.”⁴

Më vonë, “rregullore për minierat u vendosën zyrtarisht gjatë periudhës së monarkisë shqiptare (1928–1939). Ligji i parë i minierave u miratua në vitin 1929. Kromi i parë u nxor në fund të viteve 1930 në Bulqizë, në Shqipërinë Verilindore. Kompanitë italiane e zgjeruan sferën e kësaj veprimtarie minerare në fillim të Luftës së Dytë Botërore.”⁵

Para fillimit të Luftës së Dytë Botërore, “në vitet 1930, mbi tetëdhjetë për qind e popullsisë shqiptare ishte e përfshirë në forma primitive të bujqësisë.”⁶ Gjatë periudhës së ardhjes në pushtet të Enver Hoxhës, situata ekonomike nisi të ndryshojë. Krahas formimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë si kundërpërgjigje ndaj pushtimit të vendit (së pari nga fashistët italianë në 1939-ën, pastaj nga nazistët gjermanë në 1943-shin), “planet pesëvjeçare të periudhës komuniste çuan në kolektivizimin radikal të tipit sovjetik të të gjithë ekonomisë, me theks të veçantë në industrinë e rëndë.”⁷ Lidhja mes famës së industrisë minerare të Shqipërisë nga njëra anë, dhe regjimit të Hoxhës nga ana tjetër, shpjegohet nga fakti vijues: ishte qeveria komuniste e Shqipërisë ajo që në fund të viteve ’40 themeloi kompaninë shtetërore që filloi të

The history of mining in Albania goes back to the beginning of twentieth century, when “because of its rich mineral resources, the Italian geologist and paleontologist Paolo Vinassa de Regny produced the first geological map of northern Albania in 1903, during the Ottoman period.”⁴ Later on, “the official regulation of mining began during the reign of the Albanian monarchy (1928–1939), and in 1929 the first mining law was passed. The first chromite was mined in the late 1930s in Bulqiza in northeastern Albania. Italian companies expanded this mining activity at the beginning of the Second World War.”⁵ Before the beginning of the Second World War, “in the 1930s, over eighty percent of the Albanian population was involved in primitive forms of agriculture.”⁶ Around the time of Enver Hoxha’s rise to power, the economic situation started to change. Alongside the formation of the Communist Party of Albania in response to the country’s invasion (first by the Italian fascists in 1939, then by the German Nazis in 1943), “the five-year plans of the communist period led to the radical Soviet-type collectivization of the whole economy, with emphasis on heavy industry.”⁷ The connection between Albania’s fame for its mining industry, on the one hand, and Hoxha’s rule, on the other, lies in the following fact: it was the communist government of Albania that, in the late 1940s, established the state-owned company which began to mine chromite – a major export for the regime at the time.⁸

4

Daniel Göler, Matthias Bickert, and Dhimiter Doka, “Kromi çan bllokadën – Albanian Chromium Mining Revisited,” *Die Erde* 146, no. 4 (2015): 276. DOI: 10.12854/erde-146-17.

5

Po aty.
Ibid.

6, 7

Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania* [Fjalori historik i Shqipërisë], 123.

8

Një vështrim më i gjerë historik i situatës është kryer dhe regjistruar nga Departamenti i minierave të Shteteve të Bashkuara (USBM) qysh në mesin e viteve ’90. Asokohe, Walter George Steblez, ekspert në fushën minerare për Europën Lindore dhe Qendore, shkruante për industrinë minerare të Shqipërisë në përgjithësi dhe atë të pasurive të mineralit të kromit në veçanti. Lidhur me faktin që “nga viti 1945 deri në vitin 1991, industria e Shqipërisë dhe ekonomia në përgjithësi u zhvilluan nën një sistem ekonomik të planifikuar”, ai theksonte se “xeherorët e kromit, bakrit, ferro-kromit, hekur-nikelit dhe produktet e rafinimit të naftës kanë qenë mallrat minerare kryesore që janë prodhuar në Shqipëri, e që deri së fundmi kanë qenë komponentet kryesore të fitimeve në valutë të huaj”. Po ashtu, Steblez theksonte rëndësinë e një minerali në veçanti, pikërisht kromit, i cili i pat dhënë Shqipërisë famën e njërit prej furnizuesve kryesorë në botë, si përsa u takonte produkteve minerare ashtu edhe eksportit të tyre: “Operacionet e gërmimit të mineralit të kromit në Shqipëri kanë qenë pjesa më e rëndësishme e industrisë minerare të vendit. Nga fundi i viteve ’70, e përgjatë viteve ’80, Shqipëria i ka prirë prodhimin dhe eksportin të mineralit të kromit në botë, duke u renditur e dyta sa i takon eksportit dhe e treta në terma të prodhimit. Eksporti i mineraleve të kromit dhe ferro-kromit kanë qenë jetike për shkëmbimet valutore.” Shih Walter G. Steblez, “The Chromium Resources of Albania”, *International Geology Review* 36, nr. 8 (1994): 785–95, DOI: 10.1080/00206819409465488.

nxirrte kromin – një eksport i rëndësishëm për regjimin e asaj kohe.⁸

Kromi është një mineral i fortë, i vlerësuar për vetitë e tij anti-korozive, veçanërisht të rëndësishme për industrinë e çelikut. Nga tre rajonet kryesore gjeografike ku, deri tani, janë zbuluar dhe nxjerrë depozitet e tij në Shqipëri, si masivët e Tropojës dhe Kukësit në Verilindje, ai i Shebenik-Pogradecit në Juglindje dhe masivi i Bulqizës në Shqipërinë Qendrore, është ky i fundit që rezultoi më i rëndësishmi përsa i përket potencialit të tij të kromit.⁹ Masivi i Bulqizës përfaqëson një nga rezervat më të mëdha të kromit në të gjithë Evropën. I njohur kryesisht për burimet e pasura natyrore të një minerali me vlerë të madhe (kromit), rajoni i Bulqizës në Shqipërinë Verilindore, afër qytetit me të njëjtin emër (Bulqizë), ruan me krenari trashëgiminë komuniste të një qendre minerare të Shqipërisë: “Me shenjë e parë të mineralit, shfaqur në vitin 1942, miniera e kromit në Bulqizë filloi aktivitetin e saj në vitin e largët 1948, tre vjet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Si subjekt zyrtar, u emërtua fillimisht ‘Ndërmarrja Gjeologjike Bulqizë’ në vitin 1956.”¹⁰

Duke pasur parasysh që “keqmenaxhimi nga sundimtarë injorantë stalinistë lejoi shumë pak mundësi për të ndërtuar pas shembjes së diktaturës komuniste në vitet 1990–1991,”¹¹ situata e re u shënua nga një zinxhir ngjarjesh të përfshira në një proces të mjegullt privatizimi. Pas rënies së komunizmit, “për pjesën më të madhe të viteve ‘90, industria e minierave dhe

Chromite is a hard mineral highly valued for its anti-corrosive properties, especially welcome in the steel industry. Out of three main geographic regions where its deposits in Albania have been detected and extracted thus far (the Tropoja and Kukës massifs in the north-east, the Shebenik–Pogradec massif in the south-east, and Bulqiza), it is the last of these that proved most significant in terms of its chrome potential.⁹ The region of Bulqiza in northeastern Albania, located in proximity to the eponymous town (Bulqiza), treasures the communist legacy of a mining center of Albania: “With the first signs of the mineral that appeared in 1942, the chrome mine in Bulqiza started its activity in the distant year 1948, three years after the end of the Second World War. As an official entity, it was first named ‘Bulqiza Geological Enterprise’ in 1956.”¹⁰

Given that “mismanagement by ignorant Stalinist rulers left little upon which to build when the communist dictatorship collapsed in 1990–1991,”¹¹ the new situation was marked by a chain of events shrouded in a cloudy privatization process. After the fall of communism, “for much of the 1990s, the chromite mining and processing industry paralleled the country’s moribund economy. In 1995 the Albanian government adopted a law to privatize the mining industry. Administrative preparation began in 1996 and to date the government continues to grant exploration concessions to international companies and individuals.”¹²

8 A broader insight into the historical situation was given and recorded by the U.S. Bureau of Mines as early as the mid-1990s. This was when Walter George Steblez, an expert in Central and Eastern European minerals, wrote about the mineral industry of Albania in general, and the chromite resources in particular. With regard to the fact that “from 1945 until 1991, Albania’s industry and general economy developed under a system of central economic planning,” he pointed out that “chromite, copper, ferrochromium, nickeliferous iron ore and petroleum refinery products were the chief mineral commodities that have been produced in Albania and, which until recently, constituted the major component of foreign exchange earnings.” Additionally, Steblez highlighted the significance of one particular mineral, namely – chromite, which earned Albania the reputation as a major world supplier – in terms of both mine production and exports: “Albania’s chromite mining operations were the most important component of its mineral industry. From the late 1970’s through the 1980’s, Albania had been a leading world producer and exporter of chromite, usually ranked second in terms of export and third in terms of production. Exports of chromite and ferrochromium have been vital earners of foreign exchange.” See Walter G. Steblez, “The Chromium Resources of Albania,” *International Geology Review* 36, no. 8 (1994): 785–95, DOI: 10.1080/00206819409465488.

9

AEA – Albania Energy Association, “Mineral Resources and Mining Activity in Albania [Burimet minerale dhe veprimtaria minerare në Shqipëri],” Shih gjithashtu See also AKBN – National Agency of Natural Resources, “Current Situation of Mining Industry, Exploration and Mineral Potentiality in Albania, Focused on Chrome and Nickel [Situata aktuale e industrisë minerare, kërkimit dhe potencialit mineral në Shqipëri, me fokus kromin dhe nikelin],” *Tokyo Briefing* (2008).

https://mric.jogmec.go.jp/kouenkai_index/2008/briefing_080827_3_1.pdf

përpunimit të kromit pasqyroj ekonominë në vdekje e sipër të vendit. Në 1995-ën qeveria shqiptare miratoi një ligj për privatizimin e industrisë minerare. Përgatitja administrative nisi në vitin 1996 dhe, deri më sot, qeveria vazhdon t'u japë koncesione kërkitimi kompanive dhe individëve ndërkombëtarë.¹²

Një prej tyre ishte pasardhësi i Ndërmarrjes Gjeologjike Bulqizë, AlbChrome, "i themeluar si firmë shtetërore me emrin 'Albkrom sh.a.' në fillim të vitit 1991, kur, me rënien e regjimit komunist, u lirua rruga për biznesin privat dhe zhvillimin profesional të industrisë."¹³ Por nocioni i "lirisë" paskomuniste në sferën e minierave mbetet i njëanshëm dhe kërkon njohuri kritike të mëtejshme rreth natyrës së biznesit privat dhe zhvillimit të industrisë në Shqipërinë pas-enveriste, veçanërisht sa u takon atyre që mbajnë barrën e kësaj industrie më shumë se kushdo tjetër – minatorëve. Pse kështu?

Së pari, sepse fantazma e "kapitalizmit të egër" që përndjek ekonominë shqiptare të tranzicionit, në ngjashmëri me vendet e tjera të rajonit, ka qenë e drejtuar nga fitimi me çdo kusht – përfshirë dinjitetin njerëzor. E shprehur ndryshe, me krijimin gradual të një mjedisi të mjegullt biznesi të bazuar në parimet e tregut të lirë, interesat politike dhe financiare të elitave sociale në zhvillim e sipër, shpesh merrnin përparësi mbi të drejtat dhe përfitimet e papërcaktuara qartë të punëtorëve. Së dyti, sepse shfrytëzimi financiar i minierave ka qenë në duart e pronarëve privatë, si AlbChrome, një nga kompanitë më të mëdha në vend, e cila qartazi mban lidhje të ngushta me regjimin aktual politik të Shqipërisë në përgjithësi, dhe Kryeministrin Edi Rama në veçanti.¹⁴

One of them was AlbChrome, the successor of the Bulqiza Geological Enterprise, "first founded in the beginning of 1991 as a state company under the former name 'Albkrom sh.a.', when, with the fall of communist regime, the path for private business and professional development of industry in Albania, was opened and free."¹³ But the notion of post-communist "freedom" in the domain of mining remains biased and in demand of further, critical insights into the nature of private business and the development of industry in post-Enverist Albania, especially with regard to the people who carry the burdens of this industry more than anyone else – the miners themselves. Why so?

Firstly, because the specter of "wild capitalism" haunting the Albanian transitional economy, similar to other countries in the region, has been profit-driven at any cost – including human dignity. In other words, with the gradual creation of a foggy business environment, based on free-market principles, the political and financial interests of the growing social elites often prevailed over unclear workers' rights and benefits. Secondly, because the financial exploitation of mines has been in the hands of their private owners, such as AlbChrome – one of the largest companies in the country that is, conspicuously enough, very much tied to the current political regime of Albania in general and its Prime Minister, Edi Rama, in particular.¹⁴

For these and other reasons, the miners (or their widows and orphaned children), have so far been unable to generate enough public attention to change the restrictive survival

10
AlbChrome, "The History of AlbChrome [Historia e AlbChrome]."
<http://www.albchrome.al/about/our-history>.

11
Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania* [Fjalori historik i Shqipërisë], 2nd edn. (Lanham: Scarecrow Press, 2010), 123.

12
Marsela Musabelliu, "Albanian Miners: Children of the Social Injustice [Minatorët shqiptarë: Fëmijët e padrejtësisë sociale]." *The China-CEE Institute*, May 2021 [Maj 2021].

<https://china-cee.eu/2021/05/26/albania-social-briefing-albanian-miners-children-of-the-social-injustice/>

13
AlbChrome, "The History of AlbChrome [Historia e AlbChrome]."

14
Shih See "Albanian Miners Bring Protest against Albchrome in Front of Prime Minister's Office [Minatorët shqiptarë protestojnë kundër Albchrome para Kryeministrisë]." *Exit – Explaining Albania*, January 26, 2020 [26 janar 2020].

<https://exit.al/en/2020/01/26/albanian-miners-bring-protest-against-albchrome-in-front-of-prime-ministers-office/>

Për këto arsye dhe të tjera, minatorët (apo të veajat dhe fëmijët e tyre jetimë) deri më sot nuk kanë mundur të tërheqin vëmendje të mjaftueshme publike për të ndryshuar rrethanat shtrënguese të mbijetesës imponuar nga kushtet e mjeruara sociale dhe ekonomike. Çfarë megjithatë e bën Shqipërinë një vend të pasur, nuk lidhet me mirëqenien në rritje të pakicës së mbretërve dhe mbretëreshave të pakurorëzuara të biznesit, po me burimet natyrore të vendit, me në krye rezervat minerale. Ama me çfarë çmimi, në terma të jetës njerëzore, është mbajtur kjo situatë? Pavarësisht bollëkut dhe cilësisë së produktit të tyre kryesor, minatorët e punësuar në Bulqizë, si dhe ata të dalë në pension pas vitesh pune tejet të vështirë dhe të keqpaguar, konsiderohen sot si një prej grupeve më të privuara të shoqërisë shqiptare paskomuniste. Siç e ka përshkruar Fjori Sinoruka në raportin e “Balkan Insight” të qershorit 2021, për 30 vjet shteti ka injoruar kërkesat e tyre “për një status të caktuar që do të njihte natyrën e veçantë të punës së tyre dhe do të ofronte kushte pune të përmirësuara, pensione dhe sigurim shëndetësor.”¹⁵

Gjatë dekadës së fundit, disa prej mediave vendase e ndërkombëtare kanë raportuar të dhëna për kushtet e rënda të jetesës dhe punës së minatorëve shqiptarë. Shpesh ato theksojnë se nga këndvështrimi i autoriteteve publike, përgjegjëse për menaxhimin e biznesit minerar, duket se jeta e punëtorëve ka më pak vlerë se mineralet.¹⁶ Kjo është edhe arsyeja pse pasiguria dhe ekspozimi ndaj aksidenteve, apo edhe vdekjes, janë kthyer në diçka të zakonshme brenda minierave në të gjithë vendin.¹⁷

Fati i minierës së Bulqizës dhe minatorëve të saj ka ecur paralelisht me këto kushte:

conditions imposed by their miserable social and economic conditions. What still makes Albania a rich country, however, is not related to the increasing wellbeing of its uncrowned minority of business kings and queens; instead, it is the country’s natural resources, with mineral reserves at the forefront. But at what human cost has this state of affairs been maintained?

Despite the abundance and the quality of its major brand, the miners employed in Bulqiza – as well as those who have meanwhile retired after years of very hard and badly paid work – are nowadays considered one of the most deprived members of Albanian post-communist society. As described by Fjori Sinoruka in the June 2021 *Balkan Insight* report, for 30 years the state has been neglected their calls “for a special status that would recognize the unique nature of their work, providing for better working conditions, pensions and health cover.”¹⁵ Over the last decade, a number of local and international media have reported data on the grave living and working conditions of Albanian miners. They often point out that, from the perspective of the public authorities responsible for the mining business management, the workers’ lives happen to be less valuable than minerals.¹⁶ This is why insecurity and exposure to accidents, or even death, have become a common trope inside the pits across the country.¹⁷

The fate of the Bulqiza mine and its miners has been synchronous with such conditions:

15

Fjori Sinoruka, “Albanian Miners Seek Special Status, Fair Pension [Kafe dhe cigare: Minatorët shqiptarë kërkojnë status të veçantë, pension të denjë],” *Balkan Insight*, June 2, 2021 [2 qershor 2021].

<https://balkaninsight.com/2021/06/03/coffee-and-cigarettes-albanian-miners-seek-special-status-fair-pension>.

16

Ngadhujim Avdyli, “Tërmetet e minatorëve të Bulqizës”, *Kosovo 2.0*, 27 Janar 2020.

Ngadhujim Avdyli, “Miner Earthquakes in Bulqiza,” *Kosovo 2.0*, January 27, 2020.

<https://kosovotwopointzero.com/en/miner-earthquakes-in-bulqiza/>

17

Shih See “Bulqiza,” *Exit – Explaining Albania*.

<https://exit.al/en/tag/bulqiza/>

Në zonat ku ndodhen minierat, puna aty zakonisht përbën burimin e vetëm të të ardhurave për komunitetet përreth. Megjithatë, shumica dërrmuese e punës së tyre është ekstreme, e rrezikshme, e paguar keq, dhe ata janë kryesisht të vetmit kontribues financiarë në familjet e tyre. Për vite me radhë ata janë përpjekur të kërkojnë nga autoritetet kushte më të mira pune dhe jetese, por pa sukses. Jo vetëm punëtorët-burra përballen çdo ditë me vështirësinë e jetës në këto komunitete; shumë shpesh në këto vende shihen plot gra, dhe edhe fëmijë. Minatorët punojnë në kushte të mjerueshme dhe shpeshherë nuk paguhen për muaj me radhë. Aksidentet e përditshme që ndodhin brenda galerive të minierave nuk dalin kurrë në dritë. Edhe kur këto aksidente bëhen publike, sajohen skenarë të ndryshëm për aksidente vdekjeprurëse (larg së vërtetës) vetëm për të shmangur përgjegjësinë. Ka ndodhur që, edhe në raste vdekjesh, fajin për aksidentin ia kanë hedhur viktimën, kurrë menaxhimi. Kushdo që guxon të ngrejë zërin pushohet menjëherë nga puna, jo vetëm sepse deri vonë nuk ka patur sindikata të vërteta që të mbronin punëtorët, por edhe sepse autoritetet kanë lidhje [...] me pronarët e minierave.¹⁸

In the areas where mines are located, mining is usually the only source of income for the surrounding communities. However, the overwhelming majority of their work is extreme, hazardous, poorly paid, and they are mostly the first and sole breadwinners of their family. For years they have tried to ask authorities for better work and living conditions, yet nothing was achieved. Not only [do] the working men struggle daily with what life in those communities has to offer, but quite often women are seen at the sites, and many times children. The miners work in miserable conditions and are not being paid sometimes for months on end. Daily accidents occurring within the mine pits never come to light. And when those accidents are made public, different scenarios for fatal accidents (that are far from the truth) are narrated just so as to avoid responsibility. It has occurred that even in cases of fatalities, the victim took the blame for the accident, never the management. Whoever dares to raise their voice is immediately fired from work, not just because until very recently there were no real trade unions defending the workers, but also because the authorities are tied [...] to the mine owners.¹⁸

Ky përshkrim i situatës aktuale (përmbledhur saktë nga Dr. Marsela Musabelliu, Drejtore Ekzekutive e Institutit Shqiptar për Studimet e Globalizimit, në raportin e saj të fundit për Institutin China-CEE, Qendra për Edukimin mbi Ambientin, dhe botuar në maj të 2021-shit me titullin “Minatorët shqiptarë: Fëmijë të Padrejtësisë Sociale”) na nxit të shtrajmë disa pyetje thelbësore: cili është statusi – dhe e ardhmja – e minatorëve të sotëm në Shqipëri? Apo, më saktë: çfarë do të duhej të përcaktonte sot kufijtë e një kuadri ligjor zyrtar për minatorët, në këtë vend paskomunist, që këta të mund ta konsideronin veten anëtarë me dinjitet të një shoqërie që supozohet të jetë demokratike?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet e shumta, që qëndrojnë pas idesë kryesore të një projekti shumëformësh me titullin *POLITIKAT MINERALE*. Duke mos patur as ata vetë një status dinjitoz në shoqëri, disa artistë pamorë shqiptarë i kanë njohur si të tyre problemet e minatorëve dhe e kanë kuptuar emancipimin e tyre si një qëllim me vlerë, e për të cilin duhet luftuar së bashku – jo domosdoshmërisht nga këndvështrimi profesional, por më tepër nga ai i klasës shoqërore të përbashkët. *POLITIKAT MINERALE* është një projekt që eksploron këto lloj lidhjesh mes grupeve të margjinalizuara për të mirën e të gjitha palëve, përfshirë anëtarët e komunitetit lokal: përpjekjet e tyre të përbashkëta kanë për qëllim të ndërgjegjësojnë për nevojën e ballafaqimit me padijen e publikut rreth kushteve të tyre, por edhe për të vënë në pyetje skajet e shfrytëzimit arrogant të qenieve njerëzore nga ana e qeverisë, pavarësisht sa “periferike” apo “e pavlerë” mund të duket jeta e tyre...

Cili është sot statusi i artistëve pamorë bashkëkohorë në Shqipëri? Ose, për të qenë më të saktë: çfarë i përcakton kufijtë e një kuadri ligjor zyrtar për artistët pamorë në këtë vend paskomunist, që këta të mund ta konsiderojnë veten anëtarë me dinjitet të një shoqërie që supozohet të jetë demokratike? Jo shumë, për të qenë të ndershëm – vetëm nëse pyetja do të nënkuptonte anën e errët të ligjshmërisë.

This description of the current situation (hereby properly summarized by Dr. Marsela Musabelliu, executive director of the Albanian Institute for Globalization Studies, in her recent report for the China-CEE Institute published in May 2021 and entitled “Albanian Miners: Children of the Social Injustice”) reminds us of some crucial questions to be posed: what is the status – and the future – of contemporary miners in Albania? Or, to be more precise: what defines nowadays the margins of an official legal framework for miners in this post-communist country to be able to consider themselves *dignified* members of an allegedly democratic society?

These are only some out of many questions that lie behind the main idea of a multiform project entitled *MINERAL POLICIES*. Themselves lacking a dignified status in their own society, some visual artists in Albania have recognized miners’ problems as their own, and perceived their emancipation as a valuable goal to fight for *together* – not necessarily from a professional perspective, but rather from the one proper to their common social class. *MINERAL POLICIES* is a project that explores these kinds of connections among various marginalized groups for the sake of all those involved, including local community members: their joint endeavors aim at raising more awareness about the need to have their conditions exposed to the general public and to put into question the limits of the government’s arrogant exploitation of human beings, no matter how “peripheral” or “disposable” their lives may seem to be...

So, what is the status of contemporary visual artists in Albania today? Or, to be more precise: what defines the margins of an official legal framework for a visual artist in this post-communist country to be able to consider themselves a dignified member of an allegedly democratic society? Not much, to be honest – unless the question implies the darker side of legality. In a country that still puts a strong emphasis on who supports the policy of the ruling party and who does not (even if one happens to be an artist–entrepreneur) rather than on providing equal opportunities for

Në një shtet ku ende merr rëndësi përkatësia në kauzën e partisë politike (qoftë edhe në rastin e një artisti–sipërmarrës), në vend të mundësive të barabarta për të gjithë – edhe për ata artistë pamorë që nuk kanë përkatësi të qarta politike – ligji mundet lehtësisht të ndryshohet përgjatë rrugës së shtruar nga afërsia e dikujt me grupimin politik në fuqi. Kështu, statusi ligjor ngjan i parëndësishëm teksa ligji i më të fortëve mbizotëron në çdo nivel: në atë se cili konsiderohet si kontribues i vlefshëm në skenën artistike dhe cili jo; kujt i jepet mbështetje financiare e mjaftueshme dhe e vazhdueshme për prodhimtarinë artistike nga shteti dhe kujt jo; puna e kujt do të ekspozohet brenda dhe jashtë vendit dhe puna e kujt jo; kush do të emërohet në vendin e drejtorit artistik të institucionit shtetëror dhe kush jo... Kufijtë e një kuadri ligjor për artistët pamorë në Shqipërinë bashkëkohore, ashtu si edhe për këdo tjetër, janë tejet të lakueshme dhe e drejta ligjore mbetet në varësi të kujtdo që mban qendrën e pushtetit administrativ dhe atyre që kanë lidhjet më të forta me atë qendër, qoftë kjo hapur apo prapa dyerve të mbyllura.

I iniciuar nga Qendra për Artin Bashkëkohor ZETA në verën e 2021-shit dhe i mbështetur nga Fondacioni Kulturor Zviceran në Shqipëri, *POLITIKAT MINERALE* zgjati, në fazën e vet paraprake, tre muaj (gusht–tetor 2021) në qytetin e Bulqizës dhe të Tiranës. Natyrisht, projekti nuk u mbështet nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë (dhe as edhe nga Bashkia e Tiranës, meqë bie fjala): këto institucione kanë axhendën e tyre, çka është legjitime, e megjithatë projektet e shpërfillura prej tyre vazhdojnë të tërheqin vëmendjen në anët “më të ndritshme” të realitetit të zymtë politik në vend. Pavarësisht shkëlqimit të fshatrave Potemkin (përndryshe të quajtura “art në hapësirën publike”), apo shfaqjeve madhështore të mbështetësve dhe oportunistëve politikë (të ashtuquajturave ekspozita “historike” ose “retrospektive”), këto reklama gjithmonë fshehin një anë më të errët të pëvojës reale.

Qysh në pikënisje, projekti u konceptua në shumë nivele. Ai nisi si një program rezidencial veror në rajonin industrial të Shqipërisë

all – even if they happen to be mere visual artists without clear political affiliations – the rule of law can be easily adjusted along the road paved by one’s proximity to the political faction in power. Thus, legal status seems to be irrelevant when the law of the strongest prevails on so many levels: in defining who is recognized as a valuable contributor to the artistic scene and who isn’t; who is given sufficient and continuous financial support for artistic production by the state and who isn’t; whose work gets a chance to be publicly exhibited both at home and abroad, and whose doesn’t; who gets to be nominated to the rank of an artistic director of state-run institution and who doesn’t.... The margins of a legal framework for visual artists in contemporary Albania—just like for anyone else—are extremely flexible and the rule of law depends on who holds the center of administrative power and who is most strongly aligned with that center, within and beyond the public view. Initiated by ZETA Center for Contemporary Art in Summer 2021 and supported by the Swiss Cultural Foundation in Albania, *MINERAL POLICIES* was held, in its preliminary phase, over the course of three consecutive months (August–October 2021) in the town of Bulqiza and the city of Tirana. Of course, it was not supported by the Ministry of Culture of Albania (or by the Municipality of Tirana, for that matter): these institutions have their own agenda, which is legitimate, but the projects falling under their radar continue to shed light onto the “sunnier” side of the country’s grim political reality. No matter how shiny its Potemkin villages (otherwise called “art in public space”) or grand shows of political supporters and opportunists (otherwise called “historical” or “retrospective exhibitions”) may appear at first sight, these displays always mask a darker side of lived experience. From the beginning, the project was conceived at several levels. It started as a summer residency program in the industrial region of northeastern Albania where four selected artists and activists from Tirana (Blerta Hoçja, Diana Malaj, Pleurad Xhafa, and Ergin Zaloshnja) created a collective body of works in close

Verilindore, ku katër artistë dhe aktivistë të përzgjedhur nga Tirana (Blerta Hoçia, Diana Malaj, Pleurad Xhafa dhe Ergin Zaloshnja) krijuan një grup veprash kolektive fare pranë minatorëve lokalë, duke ruajtur megjithatë sferën vetjake e të veçantë të veprimit. Pas programit veror u organizua një ekspozitë publike e titulluar *Çdo goditje pason tjetrën*, në të cilën u shfaq një përzgjedhje e video-veprave të reja në një ambient instalacioni, si edhe disa objekte “misterioze” të krijuara për të njëjtin event. Ekspozita, e kuruar nga Vincent W.J. van Gerven Oei, mbeti e hapur nga data 11 nëntor 2021 deri më 30 janar 2022, në ambientet e Qendrës së Artit Bashkëkohor ZETA, në qendër të Tiranës. Në momentin që shkruajmë (janar 2022), është planifikuar që kjo të shfaqet gjatë vitit në vazhdim edhe për qytetarët e Bulqizës, në po atë rajon industrial ku nisi gjithçka. Gjithashtu, një panel diskutimi i datës 2 tetor 2021, mbajtur në Qendrën ZETA, bëri bashkë figura të zgjedhura publike për të diskutuar çështje të rëndësishme për projektin. Moderuar nga Elsa Demo, gazetare e kulturës, aktiviteti përfshiu katër panelistë: Bardhul Alla, minator; Arben Malaj, politikan; Vincent W.J. van Gerven Oei, botues dhe Genc Myftiu, inxhinier industrial. Transkriptimi i bisedës së tyre me vlerë (dhe, në disa momente, tejet dramatike), së bashku me tekstin kuratorial të ekspozitës, si dhe një intervistë me rëndësi me artistët pjesëmarrës, përbëjnë një pjesë të këtij botimi dygjuhësh, i cili rrëfen çdo hap paraprak të këtij projekti dhe shërben si një dokument i shkruar dhe vizual i *POLITIKAVE MINERALE* – një përpyetje e vogël por me rëndësi e skenës së pavarur të artit pamor të Shqipërisë.

proximity with the local miners, while still maintaining their own discrete sphere of action. The summer program was followed by a public exhibition, entitled *Each Strike Leads to the Next*, featuring a selection of newly produced video-works in an installation-setting also exposing a few “mysterious” objects created on the same occasion. The exhibition, curated by Vincent W.J. van Gerven Oei, was on view between November 11, 2021 and January 30, 2022 at the premises of ZETA Contemporary Art Center in downtown Tirana. At the time of this writing (January 2022), it is also planned to be shown at a later point this year to the citizens of Bulqiza, in the same industrial region where everything actually started. Additionally, a panel discussion held on October 2, 2021 at the ZETA Center for Contemporary Art in Tirana brought selected public figures together to discuss issues relevant to the project. Moderated by Elsa Demo, a cultural journalist, the event included four panelists: Bardhul Alla, a miner, Arben Malaj, a politician, Vincent W.J. van Gerven Oei, a publisher, and Genc Myftiu, an industrial engineer. The transcript of their valuable (and, at times, dramatically exciting) conversation, together with the curatorial text accompanying the exhibition, as well as a critical interview with participating artists, comprise part of this bilingual publication that encompasses all previous steps of the project and serves as a written and visual document of *MINERAL POLICIES*, a small but important endeavor of Albania’s independent visual art scene.

THE WOUNDS

AT THE
SOURCE

Më poshtë vijon transkripti i bisedës publike mbajtur më 2 tetor 2021 në Qendrën ZETA për Artin Bashkëkohor në Tiranë. Moderuar nga Elsa Demo (*ED*), gazetare e kulturës me katër panelistë të ftuar: Bardhul Alla (*BA*), minator; Arben Malaj (*AM*), politikan; Vincent W.J. van Gerven Oei (*VGO*), botues dhe Genc Myftiu (*GM*), inxhinier. Synimi ishte të hidhej dritë mbi një plagë sociale që lidhet me qytetin minerar të Bulqizës në Shqipërinë verilindore, kushtet e theksuara të shfrytëzimit financiar të tij nga kompanive private, si AlbChrome, si dhe mbi statusin e paprivilegjuar social dhe ekonomik të minatorëve që punojnë atje dhe jetën e përditshme të familjeve të tyre.

This is the transcript of a public talk held on October 2, 2021 at the ZETA Center for Contemporary Art in Tirana. Moderated by cultural journalist Elsa Demo (*ED*), the event brought together four panelists: Bardhul Alla (*BA*), mine worker; Arben Malaj (*AM*), politician; Vincent W.J. van Gerven Oei (*VGO*), publisher; and Genc Myftiu (*GM*), engineer. The aim was to shed light on a social wound associated with the mining town of Bulqiza in northeastern Albania, the underlining conditions of its financial exploitation by private companies, such as AlbChrome, as well as the underprivileged social and economic status of miners working there, and everyday life of their respective families.



ED

Kjo bisedë publike me titull “Plagët e burimit” përqipet të depërtojë në origjinat e plagëve të një prej burimeve kryesore të tokës shqiptare, industrisë minerare. Takimi bëhet në kuadër të një projekti më të gjerë, që ka disa muaj që ka filluar, “Politikat e mineralit”, organizuar nga Qendra ZETA. Sot, në këtë panel diskutimi janë të ftuar ekonomistë, ekspertë të industrisë

ED

This public conversation, entitled “The Wounds at the Source,” attempts to unearth the origin of the wounds plaguing one of Albania’s primary natural resources: the mining industry. The meeting makes part of a broader project organized by ZETA Contemporary Art Center: the project is called *MINERAL POLICIES*, and has been underway for several months since

minerare, minatorë dhe studiues të artit. Kemi z. Arben Malaj, i cili ka pasur një rol aktiv si ish-Ministër i Financave për një periudhë të gjatë në qeverisjet e së majtës...

AM

...progressiste...

ED

..., midis viteve 1997–2005; Bardhul Alla, i cili prej dhjetë vitesh është punëtor në minierat e Bulqizës, konkretisht në minierën që administrohet nga kompania “Albchrome”; Vincent W.J. van Gerven Oei, botues nga Holanda, njohës i mirë i skenës artistike shqiptare për të cilën kontribuon vazhdimisht nëpërmjet shkrimeve analitike; Genc Myftiu, i cili deri në vitin 2000 ka drejtuar Institutin e Minierave. Dy fjalë pse pranova të përfshihem në këtë projekt. Së pari, si gazetarë e kulturës që ka vënë re regres në drejtim të politikave kulturore për artin bashkëkohor në Shqipëri. Këta artistë të rinj kanë mbijetuar, jo thjesht artistikisht, duke i bërë rezistencë atij presioni që vjen nga mungesa e politikave për artin dhe kulturën në Shqipëri. Së dyti, për arsye personale. Vij nga një familje naftëtarësh, nga Fieri. Fati i tri brezave të naftëtarëve që kanë punuar në fushat e naftës, ashtu si edhe fati i minatorëve, është fat tragjik. Kemi humbur njerëz të afërt, njerëz të afërt na janë aksidentuar në punë... Po të shikojmë, jo vetëm shifrat, por edhe ato botime që janë bërë për të aksidentuarit në këto dy fronte të industrisë shqiptare, do të kemi një panoramë tragjike që nuk mjafton ta quajmë vetëm të tillë, “tragjike”, po që kërkon analiza, ekspertizë dhe, mbi të gjitha, kërkon ndërjegjësim. Do të doja ta fillonim nga Bardhuli. Para këtij takimi po diskutonim për rrugën që minatorët duhet të bëjnë çdo turn, që aty ku përfundon qyteti i vjetër i Bulqizës e deri sipër malit nën të cilin fshihet minerali i kromit. Po thoshim që

the beginning of Summer 2021. The speakers invited to today’s discussion include a selection of mining industry experts, mine workers, and art scholars.

One of them is Arben Malaj. Between 1997 and 2005, he played an active role as the long-standing former Minister of Finance in the left-wing government of Albania.

AM

...progressive...

ED

Another speaker is Bardhul Alla. For the last ten years, he has been working in the Bulqiza mines, specifically in the one managed by the AlbChrome company. Vincent W.J. van Gerven Oei, a publisher from the Netherlands, is also our guest today. Well-acquainted with the Albanian art scene, he constantly contributes to it via his analytical writings in various online and printed publications. Finally, we have the pleasure to introduce Genc Myftiu, who used to be the head of the Mining Institute of Albania from 1992 until 2000. Before we start, let me say a few words about the reasons why I have agreed to participate in this project. Firstly, it is because my job of a cultural journalist has made me aware of a certain regression in terms of national cultural policies regarding contemporary art in Albania. This is primarily related to younger generations of artists. Their modes of survival (not only in artistic terms) have been marked by their modes of resistance to a particular sort of pressure caused by the lack of democratic and long-term policies that aim at supporting art and culture in Albania. Secondly, I took part in this project for personal reasons. I come from a family of oil field workers from the city of Fier. Three generations of oil field workers in my own family share their tragic fate with the fate of Albanian mine workers and their families. On both sides, people close to us have been lost due to injuries suffered at work. If we take a look — not solely at the statistics, but also at texts that have been published so far,

është gati një kilometër. Bardhul, sa e gjatë është, në fakt, rruga që bëni për çdo ditë, dhe a mund të na përshkruash një ditë tënden të zakonshme në minierë?

BA

Fillimisht, ju falënderoj për këtë mundësi ku të rrëfejme përditshmërinë tonë dramatike. Në fakt, rruga që bëjmë përditë është e gjatë. Na duket sikur dalim nga shtëpia për në një kafe, ngaqë është e përditshme. Deri në zonën D, sipër, shkon deri dy kilometra. Përshëndetesh çdo ditë me familjen përpara se të dalësh nga shtëpia, sepse galeria është si të shkosh në luftë. E di që shkon, po mund edhe të mos dalësh i gjallë. Ka ndodhur që punëtorët nuk janë kthyer më në shtëpi, të gjallë.

ED

Po prindërit e tu? Babai?

BA

Babai ka punuar në minierë, si normist, deri në vitin 1995. Vdiq 42 vjeç. Po ashtu edhe vëllai ka punuar në minierë. Është aksidentuar në vitin 2001: e ka kapur korrenti dhe ndërroi jetë. Jemi tre breza që kemi punuar dhe punojmë në minierë. Familjarisht kemi kontribuar ndër

addressing the injured workers on these two major fronts of the Albanian industry — we will witness a tragic picture indeed, which demands much more attention instead of merely being called “tragic” and requires proper analysis, expertise, and, above all, a higher level of awareness.

I would like to begin with Bardhul Alla, if you all agree. Prior to this meeting, we were discussing the physical distance between two points — the perimeter of the old town of Bulqiza and the top of a mountain with chrome reserves — that the mine workers have to cross every day before each shift. We concluded that this distance comprises almost a kilometer in length. Bardhul, what is exactly the length of a journey that you make every day, and could you describe an ordinary day you spend at the mine?

BA

First of all, I would like to express my gratefulness for the opportunity to share our dramatic daily routine with all of you. It is true that our journey is long, but it has become a habit. To us, it feels as though we are leaving home every morning to get a cup of coffee outside. It can take up to two kilometers to arrive at the point called the zone D. Every mine worker makes sure to greet his family each and every day before his departure, because going to the mine gallery is like going to war. You go, but you may not make it out alive. There have been workers who never made it back home alive.

ED

And what about your parents? Your father, for instance?

BA

My father used to work as an overseer of the mine until 1995. At 42, he passed away. My brother worked in the mine as well. In 2001, he died after being accidentally electrocuted. We represent three generations of men who have worked and are still working in the mine.

dekada për shtetin shqiptar, dhe nuk kemi marrë asgjë mbrapsht.

ED

Në këta dhjetë vjet, a ka pasur një moment kthese për mirë, apo kthim mbrapa?

BA

Është njëlloj si dhjetë vjet më parë, në mos me thënë edhe më keq. Punëtorëve po u mohohet e drejta e fjalës, kanë frikë të kërkojnë të drejtat e tyre. Unë jam pjesë e Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, që është themeluar në prill 2019 dhe është njohur nga Gjykata në tetor të po atij viti. E shpallëm në qendër të qytetit të Bulqizës dhe një javë më pas mbajtëm një protestë dyjavore. U angazhua e gjithë punësoria. E deshëm këtë sindikatë, sepse buronte nga vetë minatorët si njohës të mirë të problematikave të shumta, dhe për të cilat sindikatat e tjera, që janë shumë në numër dhe të kompromentuara nga institucionet vendore, nuk kanë ekspertizë. Protestat ishin të organizuara goxha mirë dhe me pjesëmarrje të lartë. Pastaj nga presioni i kompanive të kromit filloi një rrjedhje e punëtorëve, pra filluan të ktheheshin në punë. Të gjithë nga halli.

ED

Kur u krijua sindikata kishte entuziazëm...

BA

Po, kishte shumë.

ED

Tani po thonë që ky organizim...

AM

...ka dështuar.

For decades, our family has contributed to the Albanian state. Yet, we have received nothing in return.

ED

In these past ten years, would you say you have noticed a turn for the better or the worse?

BA

Nowadays, the situation is the same as it used to be ten years ago, if not even worse. Workers are still being denied their right to express their opinion freely, and they are afraid of demanding their own rights. I am a member of the Union of the United Miners of Bulqiza, founded in April 2019 and recognized by the court in October of the same year. We announced its establishment in the center of Bulqiza. A week later, we held a protest that lasted two weeks. All the workers took part in it. This union was important to us, because it was created by us, mine workers who really know the problems of our work. These are the problems about which other unions, large in size but compromised by local institutions, have no expertise in whatsoever.

The protests were organized well and had a high number of participants. Gradually, due to the pressure exerted by the chrome industry companies, the mine workers have started to leave protests and return to their daily work, one by one. They simply couldn't afford to stay and support the cause any longer.

ED

When the Union was founded, it was welcomed with great enthusiasm, wasn't it?

BA

Yes, so much.

ED

Now you are saying that this organization...

AM

...has failed.

BA

Ka dështuar, se vetë kompania e luftoi. Kompania do një sindikatë që e ka palë, dhe jo të mbrojtë interesat e punëtorit. Pas themelimit së sindikatës, hoqën nga puna kreun e saj, Elton Debreshin, dhe tre anëtarë të tjerë.

ED

Eltoni mendohej të ishte sonte me ne, në këtë panel, por ai ka emigruar drejt Gjermanisë dhe ky është tregues i presionit që sindikata ka pasur, apo jo?

BA

Patjetër.

ED

Cila është arritja juaj kryesore në këto dy vite e gjysmë, përveç përpjekjeve për të fituar statusin e minatorit?

BA

Punëtorët janë entuziastë dhe të frymëzuar. Ndërsa pronarët frikësohen se do të përballen me diçka të re, me ndërgjegjësimin e punëtorëve për të drejtat e tyre. Statusi i minatorit është shumë i nevojshëm dhe i vonuar. Në dhjetor 2020, ne bëmë një peticion dhe mbledhëm 11 mijë firma. Ua dorëzuam institucioneve përgjegjëse, por pati injorim nga ana e tyre. Ndër kërkesat imediate ishin rritja e pagave dhe investimeve në përmirësimin e kushteve të punës. Por asgjë nuk ndodhi.

ED

Në vitin 2018, Kryeministri Edi Rama, pikërisht në Bulqizë premtoi sërish një status të minatorit.

BA

Në fakt statusi i minatorit është premtuar sa herë ka pasur zgjedhje vendore dhe

BA

It failed because the mining company (AlbChrome) undermined it. The company wants a union that is supportive of its own business policy, not the one that protects the workers' interests. Following the establishment of the Union, its leader, Elton Debreshi, and three other members were fired.

ED

Elton was supposed to be here with us today, as a member of this discussion panel, but meanwhile he immigrated to Germany. Do you think this could be an indicator of the company's pressure exerted upon the union?

BA

Certainly.

ED

In addition to your attempt to receive the desired legal status of a mine worker, what has been your primary achievement during these last two and a half years?

BA

The workers are enthusiastic and motivated, whereas the owners fear they will have to face something unexpected — like an increased awareness among the workers regarding their own rights. The status of a mine worker is utterly necessary and long overdue. In December 2020, we filed a petition and collected 11,000 signatures. We then handed this over to responsible institutions, but there was no response on their part. Among our immediate demands were wage increases and investments in the improvement of work conditions. But, nothing has happened so far.

ED

In 2018, exactly in Bulqiza, the Prime Minister Edi Rama promised (once again) that the mine worker status would finally be established.

BA

In fact, the status we are talking about is promised every time the local and

parlamentare. Dhe asnjëherë nuk është argumentuar se çfarë e pengon realizimin e statusit, sepse ajo minierë ka kontribut shumë të madh, si për ne, si për përfitimet që ka pasur shteti.

ED

Fillimisht, këtë status e kishte propozuar në Kuvend një djalë minatori, Përparim Spahiu, ish-deputet i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

BA

Ai e propozonte më sistematikisht kur ishte në opozitë, se për sa kohë ishte në qeveri...

ED

Genci, të shkojmë në origjinat e këtij problemi. Si ndodhi që industria minerare arriti në këtë

parliamentary elections take place. Yet, what hinders the implementation of this status has never been publicly clarified, even though the mine has greatly contributed both to us and to the profits of the state.

ED

Initially, this status was proposed in the National Assembly by a mine worker's son, Përparim Spahiu, a former MP of the Socialist Movement for Integration.

BA

He proposed it more systematically when he was a member of the opposition; but when he became part of the government...

ED

Genci, let us get to the bottom of this issue. How did it happen that the mining industry was




Vijon në faqen
Continues on page

34

ZETA Contemporary Art Center

Pamje aksonometrike e trupit minerar të kromit dhe punimeve të kryera në Minierën e kromit, Bulqizë, dhe në zonën përreth saj.



An axonometric image of the entire body of chrome and the mining work carried out in the Bulqiza Chrome Mine and the surrounding.

Qendra e Artit Bashkëkohor ZETA

2
3





HISTORIK
I SHKURTËR
I MINIERËS
SË BULQIZËS

—

SHORT
HISTORY
OF THE
BULQIZA MINE

Short history of the Bulqiza mine

Historik i shkurtër i minierës së Bulqizës

Vendburimi dhe miniera e kromit, Bulqizë, ndodhen në pjesën Verilindore të Shqipërisë. Për sasinë e rezervave që ka, përmbajtjen e lartë të mineralit të kromit dhe përbërjen e përshtatshme për trajtimin e mëtejshëm metalurgjik, ky vendburim renditet si vendburim i rëndësishëm i mineralit të kromit në botë dhe më i rëndësishmi në Evropë. Shenjat e para të shfaqjeve të mineralit të kromit në Bulqizë janë shënuar në zonën jugore të saj, në vitin 1942. Mbi bazën e këtyre shfaqjeve është punuar për nxjerrjen e mineralit të kromit gjatë viteve 1942–1944. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, italianët filluan prodhimin e kromit, sigurisht në sasi shumë të vogla që i transportonin me mushka.

The chrome mine of Bulqiza is located in the northeastern part of Albania. Due to its number of reserves, high chrome content, and suitable composition for further metallurgical treatment, this source ranks among the most important ones in Europe and also retains its global significance. The first noted traces of chrome in Bulqiza were found in its southern part in 1942. It was largely on the basis of these findings that the work around the mineral's extraction took place between 1942 and 1944. During the Second World War, the Italians began their own production of chromium, initially in small quantities and transported by mules.



Nje mal i pasur me krom dhe një qytet që nuk do të ekzistonte pa të.

—
A mountain rich in chrome and a city that would not exist without it.

Në vitin 1943, çeta partizane e Dibrës i sulmoi me armë dhe i përzuri italianët, dhe qysh nga ajo kohë punimet për nxjerrjen e kromit u pezulluan për të rifilluar në 18 shkurt 1948, kur u krijua zyrtarisht Miniera e Bulqizës. Shfrytëzimi sipërfaqësor i kromit ka filluar në vitin 1948, duke u punuar në 6 dalje sipërfaqësore të mineralizuara. Në vitin e parë të punës, në minierën e Bulqizës

In 1943, the Italian troops were attacked by the partisan unit of Dibra and were eventually driven out of the territory. The extraction of chrome was subsequently suspended, to be resumed on February 18, 1948, the day of the official establishment of the Bulqiza Mine. The surface mining of chrome commenced in 1948, with the work undertaken on six mineralized surface

janë prodhuar 10 482 ton mineral kromi. Krahas shfrytëzimit në sipërfaqe, për të mundësuar fillimin e shfrytëzimit nën tokë të vendburimit, në vitin 1949 nisi hapja e punimeve nëntokësore të kërkim-zbulimit dhe përgatitjes së minierës. Që nga viti 1954 prodhimi i kromit ishte 100 000 ton në vit. Nga viti 1959 u rrit në 200 000 ton në vit, në vitin 1968 kaloi në mbi 300 000 ton në vit, dhe në vitet 1979–1980 arriti sasinë 400 000 ton në vit. Pas vitit 1990, prodhimi i kromit zbriti në 150 000 ton në vit, për të ardhur sot në sasinë prej 90 000 tonësh në vit.

Nga viti 1948 e deri më sot janë prodhuar afërsisht 17 milionë ton xeheror kromi me një cilësi mbi 40-44% Cr₂O₃. Janë kryer rreth 58 km punime hapjeje, 110 km punime kërkim-përgatitore dhe 12 puse vertikale me një gjatësi totale prej 2 800 m. Ka përfunduar pusi 9, duke arritur kuotën –180 m, dhe thellësinë 1 000 m nga sipërfaqja e tokës. Aktualisht, tani po punohet në kuotën –180 m, në thellësi 1 000 m nga sipërfaqja.

outlets. In the first year of operation, the work in the Bulqiza mine resulted in the production of a total of 10,482 tons of chrome. In addition to surface mining, the preparatory research and work, aimed at the underground use of the source, commenced in 1949. Starting from 1954, the chrome production reached 100,000 tons per year. In 1959, it increased to 200,000 tons per year, while the outflow hit 300,000 tons per year in 1968. Between 1979 and 1980, it reached 400,000 tons per year and, after 1990, chrome production dropped to 150,000 tons per year, presently arriving at the amount of 90,000 tons per year. From 1948 until today, approximately 17 million tons of chromium ore, with a quality of at least 40-44% of Cr₂O₃, have been produced. Roughly 58 km of excavation work, 110 km of research-preparatory work, and 12 vertical wells with a total length of 2,800 m have been completed. The well number 9 has been built, reaching the –180 m quota and a depth of 1,000 m from the ground surface. Currently, the work is underway at a quota of –180 m and 1,000 m of depth.

Procesverbale të
aksidenteve me pasojë
vdekjen në vitet
2017–2018.
—
Records of fatal
accidents in the years
2017–2018.

54	Ramazan	Skordha	58	Zjarmtar	22.02.2018	2..
54	Shpetim	Liçi	22	Minator	22.02.2018	2..
54	Klodian	Muzhika	29	Minator	22.02.2018	2..
54	Qazim	Likmeta	38	Nd/ minator	22.02.2018	2..
54	Bledion	Hoxha	29	Lopatist	22.02.2018	2..
33	Enver	Koçi	67	Minator	20.03.2018	1..
708	Farie	Llani	56	Seleksjonu	25.03.2018	
708	Dhurata	Gjoka	48	Seleksjonu	27.03.2018	1..
708	Pellumb	Xheka	54	Zjarmtar	31.03.2018	
708	Eduart	Roçi	47	Manovrus	12.04.2018	
87	Veri	Tusha	54	Mekanik	06.04.2018	
71	Hidajet	Canameti	52	Armator	10.03.2018	
43	Petrit	Milkurti	57	Zjarmtar	12.04.2018	

Për 72 vjet, qysh nga data historike e ngritjes së saj, Bulqiza ka mbajtur në kurriz një pjesë të madhe të buxhetit të shtetit, por shumë pak është bërë për vetë qytetin e Bulqizës. Miniera është vërtet një vepër gjigande, të cilën e ndërtuan mijëra burra, dhe ajo u dha emër shumë prej tyre.

Me moton “Kromi çan bllokadën”, nomenklatura e kuqe e vuri Bulqizën pothuaj në epiqendrën e platformës së saj për shfrytëzimin barbar të kësaj pasurie të çmuar nëntokësore. Bllokmenët dirigjonin që nga Tirana, po herë-herë detyroheshin të zbrisnin edhe vetë në qytetin e ftohtë në zemër të maleve për të mbajtur nën presion administratën dhe minatorët, që këta të realizonin me çdo kusht planin e parashikuar prej tyre.

Pa mohuar aspak kontributin e qindra-mijëra minatorëve, inxhinierëve e teknikëve të minierës, për vetë përqendrimin e të burgosurve në kampet e atyshme gjatë viteve të diktaturës, Bulqiza mund të konsiderohet edhe si qytet-burg. Për këtë flasin statistikat e kohës. Kështu, në vitin 1954 në Bulqizë u ngrit Burgu i të Dënuarve Ordinerë, fillimisht me 600 të dënuar: ky kamp funksionoi për rreth 30 vjet dhe përfshinte zonat nga dishenteria e Galerisë 41 e deri në zonën “D”. Katërmëdhjetëvjet më vonë, në vitin 1968, Bulqizës do t’i shtohet dhe burgu tek vendi ku do të ndërtohet Fabrika e Pasurimit të Kromit. Të burgosurit i ndërtuan të gjitha objektet sipas projektit derikur filloi montimi i makinerive. Saga e të dënuarve vazhdon edhe më tej: në vitin 1976 kampi i Burgut mori edhe zonën “D”, madje, pas vitit 1976 kampi ka patur maksimumin e të dënuarve.

burden of a considerable portion of the state budget, while very little has been done for the town itself. The mine is quite an enormous endeavor, a place built by thousands of men, many of whom have become well-known because of it. With the motto “Chrome breaks through the blockade,” the communist nomenklatura placed Bulqiza practically at the epicenter of its platform aimed at the barbaric exploitation of this precious underground wealth. The politburo members gave directions from Tirana but, from time to time, they had to make their way to the cold town in the heart of the mountains to ensure the administration and miners were kept sufficiently under pressure, so that the latter would carry out the projected plan by all means necessary. Without undermining the contribution of hundreds of thousands of miners, engineers, and mining technicians — and having in mind the high number of prisoners detained in the camps located in the area during the years of dictatorship — Bulqiza may well be considered a prison town. The statistics of the epoch testify to this. In 1954, the prison for ordinary convicts was set up in Bulqiza, with an initial number of 600 convicts. This camp operated for about 30 years and included areas that extended from the dysentery of Gallery 41 to the D area. Fourteen years later, in 1968, at the site of the future Chrome Enrichment Factory, another prison was added in Bulqiza. Until the assembly of the machines began, the prisoners had built all the facilities as detailed in the project. The saga of the convicts

Një tjetër burg u ngrit, në vitin 1985, me të burgosurit që do të ndërtonin “Qytetin e Ri” në Bulqizë. Ndërtimet u kryen me ritme të shpejta, dhe në vitin 1988 u strehuan banorët e parë në këtë lagje. Siç u tha më sipër, burgu është përdorur edhe në objekte të tjera të rëndësishme të zonës së kromeve. Minierat e Batrës dhe Tërnovës kanë patur kampe të dënuarish, po kështu edhe ndërtimi i Fabrikës së Pasurimit është bërë me kampe të dënuarish që janë përdorur vetëm në ndërtimin e këtyre objekteve. Në 28 vjet kontributi i të burgosurve ka qenë shumë i rëndësishëm. Miniera e dikurshme e centralizuar tani është fragmentarizuar në dhjetëra kompani koncesionare. Sipas Ministrisë së Energjetikës, deri në fund të 2015-ës kanë qenë aktive gjithsej 264 leje minerare shfrytëzimi për mineralin e kromit, nga të cilat tri leje janë koncesionare.

Numri më i madh i lejeve të shfrytëzimit, 117 leje ose 47% e të gjitha lejeve të shfrytëzimit, janë dhënë në rrethin e Bulqizës. Në vitin 2008, ishin 68 leje shfrytëzimi, ndërsa në vitin 2013 ky numër kishte arritur në 118. Ky numër i madh i lejeve të shfrytëzimit dhe copëtimi në ndërmarrje të vogla e bën problematike çështjen e sigurisë së punës në minierë. Në vitin 2000 u firmos nga qeveria dhënia me koncesion për 30 vjet e puseve të thellësisë së Bulqizës dhe e Fabrikës së Pasurimit të Kromit në Bulqizë dhe në Klos, si dhe Uzinat e Ferrokromit në Burrel e Elbasan. Me këto ndërmarrje “Darfo” themeloi kompaninë “DARFO ALBANIA” më 14 prill 2000. Sot në Bulqizë pasuria zhvartet nga të pushtetshmit nëpërmjet shfrytëzimit pa kriter të zonës së pasur

continued in 1976, when the prison camp took over the D area, and, after 1976, it reached its maximum number of convicts. Yet another prison was erected in 1985, by the prisoners who were to build the “New City” in Bulqiza. Construction was carried out at a rapid pace and, in 1988, this neighborhood housed its first “residents.” As mentioned above, the prison was instrumental in the erection of many other facilities in the chrome-rich area. The mines of Batra and Tërnova also housed labor camps and, indeed, it was the prisoners from these labor camps, strictly employed to carry out the construction of these facilities, who built the enrichment factory. In 28 years, the contribution of prisoners has been quite significant.

The formerly centralized mine is now partitioned into dozens of concession companies. According to the Ministry of Energy, a total of 264 mining permits were active by the end of 2015, with three of them being concessions.

The most substantial number of use permits (117, or 47% of all use permits) were issued in the Bulqiza district. In 2008, there were 68 use permits, while in 2013, the total had reached 118. This large number of use permits and partitioning into small enterprises makes the issue of work safety in the mine highly problematic. In 2000, the government signed a 30-year concession deal involving the wells, the chrome enrichment plant in Bulqiza and Klos, and the ferrochrome plants in Burrel and Elbasan. As a result of these operations, Darfo founded the

me mineral, ndërsa mijëra njerëz luftojnë për bukën e gojës duke jetuar çdo ditë me rrezikun e vdekjes dhe fshehjet e krimeve që ndodhin në galeri. Janë të pakta familjet që nuk kanë një pjesëtar të familjes minator, dhe kur pronarët e tyre kandidojnë për anëtarë të Këshillit bashkiak është fare e lehtë të ushtrohet presion për të marrë votën. Kjo flet për një kontroll të pastër të biznesit të kromit që gjeneron miliona euro. Për 12 vjet rresht politikanë, të djathtë dhe të majtë, kanë premtuar Statusin e Minatorit, por të gjithë kanë mashtruar. Dhjetëra protesta janë zhvilluar, por janë shuar menjëherë sapo drejtuesit e sindikatave kanë përfituar nga pazari i radhës. Për ironi, minatorët përfaqësohen nga pesë sindikata dhe secila bën pazar me interesa të ndryshme. Ndonjëri nga sindikalistët afrohet me qeverinë, një tjetër me opozitën, të tjerë me biznesin, dhe si përfundim asnjëri prej tyre nuk mbron interesat e minatorit.

Drafti për statusin e shumëpërfolur u mor në shqyrtim vetëm në nëntor 2018, po jo për t'u miratuar. Projektligji ishte hartuar njëlloj si statusi i naftëtarit, i cili është aprovuar nga mazhoranca, po projektligji për minatorët u hodh poshtë me argumentin se sillte pasoja negative në skemën e pensioneve.

Sot në Bulqizë operojnë 36 subjekte, pa llogaritur nënkontraktorët. Një pjesë e mirë e atyre që kontrollojnë këto biznese janë pikërisht disa prej emrave të skenës politike shqiptare. Operatori më i madh është AlbChrome. Kjo kompani shfrytëzon një sipërfaqe prej 3 500 km², në zonën jugore dhe qendrore. Parcelizimi i minierës dhe lidhja me pushtetin kanë

DARFO ALBANIA Company on April 14, 2000. Today, in Bulqiza, where wealth is extorted by those in power through the indiscriminate use of this area rich in minerals, thousands of people struggle to secure their daily bread, each day risking their lives while concealing the crimes that happen in the gallery. Rare are the families that do not have miners at home; thus, when the companies' owners run for membership in the city council, it becomes quite easy to exert pressure to get their vote. This clearly attests to a great control over the chrome business, one which generates millions of euros. For 12 consecutive years, both right-wing and left-wing politicians have promised the establishment of a "Miner Status" — a promise that has turned out to be entirely untrue. Dozens of protests have been organized and immediately canceled whenever the required bribes were handed over to union leaders. Ironically, the miners are represented by five different unions, and each of them bargains under different terms. One of the trade unionists may side with the government, another may partner with the opposing political party, yet another with the business sector, so that ultimately no one is left to protect the interests of the miners. The draft of the infamous "Miner Status" was finally discussed in November 2018 in parliament, but not in order to be passed. The draft law followed the example of the status of workers in the oil industry, i.e., "Oil Worker Status," which was approved by the majority; yet, the draft law on miners was rejected

sjellë probleme të mëdha; çënohet nëntoka, ekuilibri, rrëshqitja e dheut, me rrezik për ambjentin dhe jetën e njerëzve. Miniera e Bulqizës pretendon të ketë të paktën edhe dy dekada jetë. Nga viti 2008, në Bulqizë kanë ndodhur 221 aksidente dhe 34 vdekje.


on the grounds that it would have negative consequences on the pension scheme.

Today, a total of 36 entities operate in Bulqiza, without counting the subcontractors. A major part of those who hold control over these businesses are the same names that dominate the Albanian political scene.

The largest operator is AlbChrome. This company controls an area of 3,500 km² in the southern and central areas. The fragmentation of the mine and the latter's ties with political power have brought about significant harm: the underground and its balance are under constant threat, with possible landslides endangering both the environment and people's lives. The general belief is that the Bulqiza mine will run for at least two more decades. Since 2008, a total of 221 accidents and 34 deaths have occurred in Bulqiza.

Procesverbale të Autoritetit Ndërkombëtar për Sigurinë në Miniera që paradoksisht fajëson viktimat.

Records of the International Mining Safety Authority which paradoxically blames the victims.



Inspektorët janë të stacionuar në Tiranë dhe 4 orë janë një kohë e mjaftueshme për të manipuluar provat e aksidenteve, ndërkohë që një pjesë e tyre nuk raportohen. Minororëve u mbyllet goja me anë të shantazhit ose parave. Ata që nuk punojnë në minierë gërmojnë në stoqet e kromit jashtë galerive. Në

All inspectors are stationed in Tirana: thus, the four-hour-distance between two cities is more than enough time to have evidence of any accident manipulated, with many of these accidents not even reported. Miners are silenced via blackmail or bribery. Those who are not employed in the mine, dig

këtë proces angazhohen gra dhe fëmijë, të cilët vënë jetën në rrezik. Gjashtë aksidente kanë ndodhur në këto zona të palicencuara mes viteve 2008 dhe 2013. Kromi që nxiret në mënyre informale blihet me çmime shumë të ulëta dhe shkon më pas për eksport. Në Durrës është ndërtuar një ndërmarrje për përpunimin e krom-ferrokromit që shkon për eksport me një çmim \$1 200–1 500 për ton. Në qytetin e Bulqizës, i vetmi vend ku nuk ka dallim mes ditës dhe natës është miniera: aty puna vijon pa ndërprerë edhe kur qyteti duket i rrëmbyer nga errësira.

Genc DEMI,
Ing. Minerar, Ass. Prof.

Genc MYFTIU,
Ing., ish-Drejtori i Institutit
të Minierave

Imazhet janë shkëputur nga një video-reportazhi dokumentar i realizuar në vitin 2019 nga Top Channel, një kanal televiziv kombëtar në Shqipëri, me titull “Mafia e Kromit” (me titra në anglisht).

for chrome in the stocks outside the galleries. Many women and children put their lives at risk during this process. A total of six accidents occurred in these unlicensed territories in the period between 2008 and 2013. Informally extracted chrome is purchased at very low prices and subsequently exported. A chrome-ferrochrome processing plant in Durrës exports its minerals at a price of \$1,200–1,500 per ton. In the town of Bulqiza, the only place where day is indistinguishable from night is the mine: there, work continues uninterrupted even as the city is enveloped in darkness.

Genc DEMI,
Mining Engineer,
Assistant Professor

Genc MYFTIU,
Engineer, former Director
of the Institute of Mines

The images are taken from a documentary produced in 2019 by Top Channel, a national commercial television channel in Albania, entitled “The Chrome Mafia” (with English subtitles):

<https://www.youtube.com/watch?v=J5jdEIZ2y5E>



copëzim të dhënies me koncesion, kompanive të huaja fillimisht dhe pastaj atyre shqiptare?

GM

Miniera e kromit në Bulqizë është e vetmja në Europë dhe një nga më të mëdhatë në botë. Nga pikëpamja gjeologjike është nga vendburimet më interesante. Pus pas pusi, duhet gati një orë për të shkuar në disa nga galeritë më të thella. Në periudhën komuniste unë kam qenë kryemekanik i Ndërmarrjes së Ndërtimit të Minierave. Ne kemi qenë në avantgardë, hapeshin punimet në minierë, dhe pastaj vinte shfrytëzimi. Projektonim puset dhe tunelet e mëdha. Kishim pajisjet që vinin nga Suedia dhe Finlanda, sepse regjimi komunist e priorizonte industrinë minerare. Ndërsa pas rënies së regjimit komunist, në vitet 1992- 2000 kam qenë drejtor i Institutit të Minierave, i ngarkuar me detyrën për një reformë në industrinë minerare që filloi me qeverinë e Sali Berishës dhe vazhdoi me qeverinë e Fatos Nanos, e që u finalizua, por nuk ndryshoi gjë. Ideja ishte që të privatizohej ajo që ishte me leverdi dhe të mbyllej ajo që ishte pa leverdi, siç ishin minierat e qymyrgurit. Po bëj një parantezë këtu. Ne mbyllëm minierën e Valiasit me 4 mijë punëtorë, sepse ishte sikur të nxirrje gurë të padobishëm. Regjimi komunist ndërtonte pa sens ekonomik, si Kombinati Metalurgjik për shembull, që ishte një varrezë. Kështu, që të nxirrje 4 mijë punëtorë në rrugë nuk ishte e lehtë, por u gjet zgjidhja, dhe sipas reformës atyre iu dhanë dy vjet rrogë.

AM

Duhet ta sqaroj këtë moment, se ishte shumë

divided and then offered, through concessions, first to foreign companies and then also to Albanian ones?

GM

The Bulqiza chrome mine is the only one of its kind in Europe and one of the largest in the world. From a geological standpoint, it is a highly interesting natural resource location. From well to well, it takes nearly an hour to reach some of the more remote galleries, the ones located at greater depths. During the communist period, I was the chief mechanic of the Mining Construction Company. We represented the avant-garde back then, because the mining work itself came first, and exploitation came second. We designed large wells and tunnels. Our equipment was imported from Sweden and Finland, because the communist regime prioritized the mining industry. After the fall of the communist regime, I was the director of the Mining Institute between 1992 and 2000. I was in charge of reforming the mining industry, a process that the government of Sali Berisha had begun and it continued with that of Fatos Nano. While this reform was finalized, nothing else changed. The idea here was to privatize what was profitable and close what was unprofitable, such as the coal mines. I would like to mention something at this point. We closed the Valias mine, which had 4,000 workers, as mining there was like extracting useless rocks. The way of construction of the communist regime lacked economic sense: a good example is the Metallurgical Plant, which was basically a cemetery. It was not easy throwing 4,000 workers out on the street, but still a solution was found and, per the reform, the workers were paid two years' worth of salary.

AM

I have some clarifications to make about this

e vështirë situata. Mungonin sindikatat. Nga bisedat që patëm me qeveri të ndryshme, se edhe ne nuk kishim eksperiencë, këshilla më e mirë erdhi nga ministri grek, i cili tha që është e pamundur ta shpëtoni. Ai kishte parasysh sindikatat në Greqi. Ata kishin gjetur një rrugë: pas atyre që dilnin në pension, nuk hapnin më vende pune. Për shembull, nëse një vit dilnin në pension 100 mijë, ata i bllokonin dhe nuk hapnin më vende të reja pune. Për këtë rast ne kemi diskutuar gjatë, sepse ishin minierat, ishte Albtelekomi, Albpetroli..., ku shumë veta merrnin pagë mujore pa jetuar fare në Shqipëri. Ishin në emigracion, i linin bakshishin përgjegjësit të turnit dhe merrnin pagat. Duke patur parasysh që kishte shumë varfëri dhe kriza e '97-ës ishte e thellë, nuk kishte reagime sociale për reforma. U pa e udhës që punëtorëve t'u jepnin paga për dy vjet, një shumë e barabartë për të hapur një biznes të vogël dhe nxorëm listat.

Në disa, siç ishte Albpetroli dhe Albtelekomi, ne kishim më shumë veta që donin të iknin nga puna nga ç'e kishim parashikuar. Thuhet që varfëria është nëna e krimit, dhe reformën nuk duhet ta bësh thjesht se duhet të shkurtosh vendet e punës. Kështu që ata morën pagat në dorë për dy vjet dhe filluan bizneset e vogla.

GM

Një pjesë e reformës ishte privatizimi, dhe zunë minierat e kromit, sepse ishin të vetmet miniera me leverdi përfitim të lartë. Po një platformë reforme privatizimi mban parasysh edhe ndërhyrjen sociale për punëtorët. Miniera e Bulqizës në fillim u la një e vetme, po për minierat e tjera më të vogla, vumë një 'fee' të vogël, rreth 500 dollarë për ndihmë. Të gjitha projektet e ndarjes së minierave dhe unifikimit të tyre i kemi bërë ne si Institut, sepse kishim ekspertë për këtë.

Për minierën e Bulqizës u bë një tender i madhë ndërkombëtar, me pjesëmarrjen e kompanive të njohura. Po kështu, u aktivizua edhe debati me sindikatën: pse e dha shteti

particular historical moment, because the situation was very difficult. There were no trade unions. From the conversations we had with different governments — as we also lacked the experience — the best advice came from the Greek minister, who said it was impossible to save it. He had in mind the unions in Greece, which had managed to find a solution. They closed the positions as soon as workers got retired. For instance, if 100,000 retired in a year, there would be no new hiring; the positions were permanently closed. We have discussed this case extensively, because it was precisely in the mines (run by companies active back in times, such as AlbTelekom and AlbPetrol) that many people received a monthly salary without living in Albania at all. They lived abroad, but they kept receiving full salaries by tipping the overseers of their shifts. Given the poverty of that time and the economic crisis of 1997, there was no social outcry for reforms. We deemed it appropriate to offer workers two years' worth of wages, an amount which would suffice to start a small business, and, then, we published the lists. In some companies, such as AlbPetrol and AlbTelekom, more people wanted to quit than we had anticipated. Poverty is said to be the mother of crime, and reform should never be done simply to cut jobs. Thus, the mine workers received their salaries for two years and started small businesses.

GM

One aspect of the reform was privatization, and chrome mines were privatized because they were the only high-profit mines. Yet, a privatization reform platform also takes into account social intervention for workers. Initially, the Bulqiza mine was not partitioned, but for other smaller mines we granted a modest "fee" of about 500 USD in aid. We, as an Institute, implemented all of the projects for the partitioning and their unification of the mines, because we had experts for this task.

A large international tender, including the participation of well-known companies, was held for the Bulqiza mine. Additionally, a debate with the union was activated. Why did

me koncension, pse shteti nuk e mbajti menaxhimin e saj...? Ky ishte debati në vitet dymijë me sindikatën, dhe sindikatat e punëtorëve kanë qenë të fuqishme atëherë. Gëzim Kalaja...

AM

Sindikatat ishin aq serioze dhe të fuqishme sa rrëzuan dy-tri qeveri atëherë, në vitet e para të nëntëdhjetës...

GM

Ne arritëm që sindikatat t'i ulnim në tavolinë me kompanitë private. Nuk e di sa ndodh sot kjo gjë. Sot është e rëndësishme që sindikata të jetë e informuar për administrimin dhe fitimin që kompania ka nga miniera. Për shembull, kromi – po bëj një parantezë këtu – është një metal që është në bursë. Historia e tij në bursë ka lëvizur, nga 70 dollarë për ton krom në 400 dollarë për ton krom. Kur çmimi është i ulët, kompania private ul pagat, shkurton vendet e punës. Paradoksisht, kromi është metal që përdoret nga luga deri në industrinë e makinave, por e ka këtë luhatje. Kështu që, sindikata duhet të jetë vazhdimisht e përditësuar se çfarë ndodh në tregun botëror, duhet të ketë avokatë të zotë dhe shkencëtarë si konsulentë. Kur bursa shkon 400 dollarë toni, atëherë një pjesë të saj duhet ta gëzojnë

the state give it away by using a concession agreement? Why did the state not continue managing it? This was the debate of the 2000s with the trade union, and the workers' unions were strong then. Think of Gëzim Kalaja...

AM

The unions were taken very seriously then and had such power that they overthrew two or three governments in the early nineties.

GM

We managed to have the unions talk with the private companies. I am not sure whether this happens today. Today, what is of importance is that the union is informed about the administration and the company's earnings from the mine. For example: chrome — I am adding a parenthetical note here — is a metal listed on the stock market. Its stock market value has moved from 70 USD per ton to 400 USD per ton. When the price is low, the private company cuts wages and jobs. Paradoxically, though chrome is a metal used extensively, from making a spoon to the car industry, it experiences this fluctuation in price. So, the union must be kept updated on what is happening in the world market, and it must include skilled lawyers and scientists as consultants. When the stock market price of chrome goes up to 400 USD per ton, then the workers should profit as well!



edhe punëtorët.

AM

Varianti më i mirë është të krijohen fonde amortizimi të krizave, që amortizojnë goditjet e tregut.

GM

Ndodh si me çmimin e naftës, që edhe kur ulet në bursë nuk reflektohet ulja e çmimit në treg. Vitin e kaluar çmimi i naftës në bursë shkoi 1 dollarë për fuçi, kurse ne e paguam 1700. Pra, një sindikatë e mirëinformuar, mund të bëjë presion: kur çmimi i kromit është i mirë, të kenë përfitime edhe punonjësit. Kur çmimi ulet, atëherë do të vuajnë të gjithë, dhe mund të përdoret fondi i amortizimit, i cili të aktivizohet në kushte krize. Dhe kur është lulëzim, prapë të mos abuzohet, të mos pihet shampanjë. Mendoj që dikur ka pasur më shumë transparencë me sindikatën sesa sot. Atëherë sindikata kishte hotele.

ED

Dhe i ka akoma...

BA

Dhe i kanë kthyer në resorte.

AM

Ligji i njej si aksionerë, janë në bordet e sigurimeve shoqërore, janë në bordet e kompanive. Pastaj problemi është që i kompromentojnë. Nga pikëpamja ligjore, ligji është si të jesh vend përëndimor, por implementimi...

GM

Unë flas nga eksperiencia e takimeve që kam pasur me sindikata në Angli, Gjermani, Poloni. Kur Gjermania ka mbyllur minierën e fundit të qymyrit, qeveria ka bërë festë të madhe sepse për dyzet vjet kishte shpenzuar miliona.

ED

Ajo që konsiderohet si sindikata më e vjetër,

AM

The best solution is to set up the crisis amortization funds, which would mitigate any market shocks.

GM

It is similar to what happens with the price of oil. Even when its value falls on the stock market, the price decrease is not reflected in the market. Last year, the price of oil in the stock market went up to 1 USD a barrel, while we paid 1,700 USD for it. Thus, a well-informed union can pressure the company. When the price of chrome is high, employees can also benefit. When the price decreases, then everyone will suffer. Then, the amortization funds can be used. Yet, even when the situation is flourishing, one should not abuse it. One should refrain from popping open the champagne bottle, so to speak. I think that, once upon a time, there used to be more transparency regarding unions than today. Back in time, unions owned hotels...

ED

And they still have them...

BA

And they have turned them into resorts.

AM

The law recognizes them as shareholders. They are on the social security boards. They are on the boards of companies. Then the problem is the issue of being compromised. From a legal point of view, the law is the same as that of any western country, but the implementation...

GM

I speak from my own experience of meetings with unions in England, Germany, Poland. When Germany closed its last coal mine, the government celebrated this — because, for forty years, it had spent millions on it.

ED

In its updated contract with AlbChrome, the FSPISh (Federation of Industrial Workers'

Federata Sindikale e Punëtorëve të Industrisë, ka garantuar në kontratën e përditësuar me AlbChrome-in “paqen absolute ndërmjet palëve në kuptim të nenit 169 të Kodit të Punës dhe heq dorë nga greva përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate”.

BA

Po, kjo kontratë është amenduar nga kjo sindikatë që sapo përmende.

AM

Duhet parë kontrata me kujdes. Sindikata është ofruar me këtë gjë, po kompania çfarë ka dhënë? Në qoftë se kanë bërë marrëveshje që për pesë vjet do jenë në paqe, edhe kompania duhet të ketë ofruar rritje page ose një sistem bonus. Po në qoftë se kjo është dhënë pa asnjë premtim nga ana tjetër, menjëherë e kupton që sindikata është e humbur në misionin e saj.

ED

Në amendimin e kontratës, AlbChrome merr përsipër rritjen e pagave nga 10–13% për minatorët, ndërsa FSPISH në emër të minatorëve heq dorë nga e drejta e grevës. Kjo kontratë është lidhur në qershor 2020.

BA

Kur pamë këtë amendim, ne si sindikatë reaguam. E kemi denoncuar në institucionet e punës, në zyrat përkatëse, derisa e ndryshuan dhe e hoqën atë pjesë ku shkruhej për heqjen e së drejtës për protestë.

ED

U kthehemi konkencioneve: mbi ç’logjikë Qeveria “Nano” ia dha Bulqizën me konkension një kompanie italiane. Dhe Berisha më pas, deri në vitin 2010, ua jep minierën rreth 42 kompanive private?

GM

E ka filluar Qeveria “Berisha” dhënien me konkension para se të ndodhte revolucioni i

Unions, supposedly the oldest union) has guaranteed “absolute peace between the parties, based on the content of Article 169 of the Labor Code, and renounces the right to strike for the duration of this contract.”

BA

Yes, this contract has been amended by the union that you have just mentioned.

AM

The contract must be checked carefully. The union has offered this, but what has the company given in turn? If an agreement has been made on “keeping peace” for the subsequent five years, the company must have offered a pay raise or a bonus, as well. But if there is no promise by the other party, the fact that the union has lost its mission becomes immediately clear.

ED

In the contract’s amendment, AlbChrome promises between ten and thirteen percent increase of the mine workers’ salaries, while the FSPISH, acting on behalf of the mine workers, waives the right to strike. This contract was signed in June 2020.

BA

When we read this amendment, we, as a union, reacted. We denounced it in the labor institutions, at the relevant offices, until they changed it and removed the part regarding the relinquishment of the right to protest.

ED

përfshirë, përplasjet mes tyre, kërkesat e minatorëve dhe rezultatet e përplasjeve. Asnjë rast pararendës nuk i shton diçka të lënë përgjysmë rastit tjetër, po secili prej rasteve është unik, ashtu siç është edhe vetë Bulqiza. Qëllimi ynë ishte të hapnim një dimension tjetër, i cili nuk ka ndodhur akoma, ose është vetëm në fillimin e zhvillimit të tij, duke ballafaquar kështu kronologjinë e këtyre ngjarjeve historike me minatorët e Bulqizës dhe me peizazhin që ata përshkojnë çdo ditë për të shkuar në punë. Patjetër që vetë struktura e veprës i përfshin minatorët duke i konsideruar ata një trup të vetëm, të gjendur përballë fakteve historike, mishëruar brenda tyre, dhe tregon disi edhe atë që mund të ndodhë në të ardhmen e afërt. Për ne nuk kishte rëndësi nëse ata do të dëgjonin kronologjikisht, nga fillimi deri në fund. Çka ishte e rëndësishme ishte pikërisht fragmentarizimi i ngjarjeve të thëna rishtazi deri në momentin e ngjizjes së tyre me realitetin ku po performonim. Gjatë ngjitjes së malit, secili prej tyre dëgjon një fragment të ngjarjes, dhe kështu fjala që humbet nga veshi i njërit, bie në veshin e tjetrit, duke (ri)krijuar realitetin. Ky pasazh i fragmentarizuar te secili prej minatorëve nxit vetëdijen për të ripërfytyruar rrjedhën e ngjarjes, duke e përdorur imagjinatën si potencialin e një ngjarjeje që do të ndodhë në të ardhmen.

involved, clashes between them, miners' claims, and the results of these clashes. Each preceding case adds nothing that may have been left in the middle of the other case, but each case is a singular one, as is Bulqiza. Our goal was to open up another dimension — which has not yet occurred, but is at the very early stages of its development — thus confronting the chronology of these historical events with the miners of Bulqiza, and the landscape they pass through on their daily walk to work. Certainly, the work's structure in itself treats the miners as one single body, where they are confronted with historical facts, embodied within them, and which somehow reveal what can happen in the near future. It was not of particular importance to us if they would get to listen to the chronology of events in its entirety. Rather, of most importance was the fragmentation of the events as they are retold, until the moment of their conception within the present reality of our performance. While climbing the mountain, each of them hears a different fragment of the event and, thus, a word that may be lost on one, is heard by another, (re)creating reality. This fragmented passage in each of the miners triggers the consciousness to reimagine the course of the event, using imagination as the potential of an event that will occur in the future.

Çka dokumentojnë videot tuaja, duke e vënë në plan të parë, është figura e performuesit. Në këtë mënyrë, edhe radhët e minatorëve, të cilët gjithashtu shfaqen në video, marrin një rol joprotagonist. Thënë ndryshe, minatorët pasqyrohen si një masë kryesisht e padiferencuar dhe e nënshtruar, e ngjashme me "ekstrat" në një film. Kjo bie në kontrast të plotë me mënyrën se si përfaqësohen minatorët në historitë që lexohen ndërkohë me zë të lartë. Në këto histori, minatorët nuk janë më një masë e njëtrajtshme, por një komunitet i organizuar dhe një aktor me ndikim në histori. A është i qëllimshëm ky tension i krijuar?

Your video documentation foregrounds the figure of the performer, so that the streams of miners that also appear in them take on the status of extras. In other words, the miners are represented as a largely undifferentiated and subdued mass, just like the extras in cinema. This is in stark contrast to the representation of the miners in the stories that are simultaneously being read out loud. In those stories, the miners are no longer an undifferentiated mass, but rather an organized community and an active agent of history. Was this tension something that you set up intentionally?

Nuk mendojmë se kemi nxjerrë në pah figurën e artistit (interpretuesit), përkundrazi, prania jonë tenton të jetë e tëhuajuar e t'i ngjajë asaj të një fantazme që lexon shembuj të së shkuarës dhe që potencialisht mund t'i flasë këtij trupi kolektiv. Në këtë ecje golgote të përditshme, e cila është aq e përditshme sa vetë peizazhi, industria dhe miniera janë bërë pjesë e përbashkët, metabolike, e minatorëve. Pikërisht këtë proces (ende) pa subjekt ne kemi dashur ta tensionojmë duke risjellë historitë e subjektivizimeve të minatorëve dhe të betejave të tyre. Duhet thënë që ekziston një frikë e përgjithshme te minatorët për t'i shprehur pakënaqësitë e tyre publikisht, por edhe në privatësi ata janë tepër të matur. Frika për të folur është më e fortë se ajo e vetë vdekjes. Edhe jashtë orarit të punës minatorët janë të varur totalisht nga frika për të thyer “paqen absolute”, që është pika kryesore e shkruar, e zezë mbi të bardhë, në kontratën e tyre me kompaninë. Kjo pikë e kontratës e ndalon minatorin të protestojë për pakënaqësitë dhe problemet e tij. Pra, kërcënimet e kompanive, nëpërmjet sindikatave të kontrolluara prej vetë kompanive, kanë shkruar aq thellë saqë kanë certifikuar mohimin e të drejtave të njeriut dhe sigurisht të qenies së punëtorit. Nga ky këndvështrim, minatori i sotëm i Bulqizës është një figurë pa zë, i dokumentuar, i certifikuar si i tillë nga vetë kontraktori dhe kontrata e firmosur prej tij. Minatori i Bulqizës është certifikimi i të qenit extras (figurant/ë) në botën e sotme globale. Punëtori i sotëm ndodhet brenda një çarku historik, pak a shumë si ekstrat e para në historinë e kinemasë (*Workers Leaving the Lumière Factory*, 1895), por ndryshe nga kinemaja, ose filmi në fjalë, ata nuk janë të mbërthyer vetëm brenda kuadrit të tij statik, po vazhdojnë të jenë edhe jashtë tij. E vetmja mundësi që u mbetet minatorëve për ta çmontuar këtë narrativë të mbiveshur dhe këtë realitet të certifikuar, është pikërisht revolta, ngadalësimi dhe sabotimi i ingranazheve të makinerisë neoliberalë për të bërë të mundur fitoren e të drejtave të tyre. Ne u përpoqëm të përbrendësonim pikërisht këtë narrativë brenda atij realiteti.

We do not think that we have highlighted the figure of the artist (as a performer or interpreter); on the contrary, our presence tends to be alienated and resemble that of a “ghost” who reads examples from the past, and who can potentially address this collective body. In this everyday walk to the hill resembling Golgotha, the landscape itself, industry, and mining have become a unified metabolic part of the miners. Our aim was precisely the tensing up of this (still) subject-less process by bringing back the subjective stories of the miners and their battles. It must be said that the miners are beset by a general fear of expressing their dissatisfaction not merely publicly, but also privately, exercising tremendous restraint. The fear of speaking is stronger than that of death itself. Even outside working hours, miners cannot break free of the fear of disturbing the “absolute peace,” the main clause, written in black and white, of their contract with the company. This particular point prohibits the miner from protesting over his grievances and problems. Thus, through unions controlled by the companies themselves, the latter’s threats have infiltrated so deep that they have succeeded in validating the denial of human rights and those of the worker as a human being. From this viewpoint, the Bulqiza miner of today is a silent figure, documented, certified as such by the contractor himself and the contract signed by him. The Bulqiza miner is the embodied certificate of a being that is an extra in today’s global world. Presently, this worker is stuck within a historical trap, resembling the first extras in the history of cinema (*Workers Leaving the Lumière Factory*), but, unlike cinema or the movie in question, they are not merely trapped within its static framework, but continue to exist even outside of it. For the dismantling of this overlaid narrative and certified reality, the miner is left with one single option, namely, revolt: the deliberate slowing down, and sabotaging of the gears of the neoliberal machinery. Only thus can they have the opportunity to gain their rights. It is precisely this narrative within that reality that we tried to internalize.

Çka dokumentojnë videot tuaja, duke e vënë në plan të parë, është figura e performuesit. Në këtë mënyrë, edhe radhët e minatorëve, të cilët gjithashtu shfaqen në video, marrin një rol joprotagonist. Thënë ndryshe, minatorët pasqyrohen si një masë kryesisht e padiferencuar dhe e nënshtruar, e ngjashme me “ekstrat” në një film. Kjo bie në kontrast të plotë me mënyrën se si përfaqësohen minatorët në historitë që lexohen ndërkohë me zë të lartë. Në këto histori, minatorët nuk janë më një masë e njëtrajtshme, por një komunitet i organizuar dhe një aktor me ndikim në histori. A është i qëllimshëm ky tension i krijuar?

In your video documentation, the miners hardly ever make eye contact with the artist or the camera, trying their best to act as if nothing strange or unusual is going on. Yet their reaction to encountering (and being included in) an artistic performance on their way to work is both strange and unusual, with the effect of making the scene of each performance look staged. How do you explain the miners’ reaction, or lack thereof? More to the point, if artists and miners cannot even look each other in the eye, how can they hope to join each other in struggle?

Një pyetje që e kemi ngritur shpesh me njëritjetrin ka qenë: nëse gjatë performancës nuk do të kish qenë prania e kamerës, a do të ishte krijuar një tjetër marrëdhënie midis nesh dhe minatorëve? Kamera është një mjet që në kohët e sotme mbart një ngarkesë rreziku dhe njëkohësisht tenton të krijojë një raport impotence, pafuqie, lidhur me subjektin të cilit i drejtohet. Mendojmë që kjo ka ndodhur disi edhe me minatorët. Ne nuk mund të ishim dot kurrësesi pjesë e atij trupi kolektiv!

Do të duhej një proces shumë i gjatë pune për të krijuar besimin te minatorët e Bulqizës e për të arritur thyerjen e “syrit të tretë”, pra kamerës. Thënë kjo, barra bie edhe mbi artistin. Artisti i sotëm është shkëputur shumë nga periferia dhe problematikat e komuniteteve të marginalizuara dhe vetë roli i tij është vënë në pikëpyetje. Kjo sepse artisti shqiptar e kërkon suksesin vetëm duke qenë pjesë, ose ingranazh, i pushtetit politik. Kontradikta e mosbesimit vjen nga dy arsye: njëra që i përket rolit të artistit në historinë e vendit gjatë komunizmit, ku ai ishte pjesë e aparatit shtetëror, dhe tjetra nga realiteti i sotëm politik i vendit, pasi shteti drejtohet nga një “artist” që është Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Pra mund të themi se raporti i artistit me këto komunitete është i korruptuar qysh në fillim, dhe pyetja që ju ngrini shpie në një përgjigje të vetme: kur artisti të sakrifikojë çdo gjë në emër të kauzës dhe ta konsiderojë

One question that we often asked one another was: “Would another relationship have been formed between us and the miners had there been no camera during the performance?” The camera is a tool that, nowadays, implies risk and, at the same time, tends to establish an uneven rapport, granting more power to the one holding the camera and less to the subject addressed. We think this is what happened with the miners, as well. We could never become part of that collective body! A very long process of work would be required to build the trust of the Bulqiza miners, and to succeed in achieving the ‘elimination’ of the camera’s presence. That said, the burden falls on the artist as well. Today’s artist has grown increasingly detached from the periphery and the problems of marginalized communities, so much so that his/her/their role has been put in question. This doubt results from the fact that the Albanian artist seeks success strictly through becoming a part or gear in the political power machine. Two main reasons give rise to this profound sense of disbelief: one regards the role of the artist during communism, where the former was part of the state apparatus, and the other is related to the current political reality of the country, one in which the state is run by an “artist,” the Prime Minister of Albania, Edi Rama. Consequently, we can safely say that the artist’s relationship with these communities is inherently corrupt, from the point

punën e tij si një mision, ai jo vetëm do të mund t'i shohë në sy minatorët, apo komunitetet e tjera të skajuar, por edhe vetë qëndrimi i tij (i artistit) do të jetë pjesë e këtyre realiteteve – një vështrim kolektiv i drejtuar kundër pushtetit.

Në Bulqizë, konflikti mes minatorëve, pronarëve të minierave, nënbotës së kriminit dhe politikanëve është i ashpër dhe i vazhdueshëm, duke krijuar një atmosferë kërcënuese që duket sikur depërton e mbështjell brenda vetes çdo aspekt të jetës e realitetit, përfshirë edhe peizazhin e zymtë të qytetit. Duke parë minatorët gjatë ngjitjes së tyre në kodër, të krijohet përshtypja se ata janë të vetëdijshëm që po vëzhgohen, thua edhe vetë peizazhi po i vrojton. A mund të thoni diçka për temën e kontrollit në Bulqizë, dhe për atë se si prania e këtij kontrolli ndikoi në realizimin e projektit?

Rruga zigzage që përshkoi minatorët në malin e kromit ishte si një trajektore e përcaktuar paraprakisht, e cila krijonte një peizazh të privatizuar, e si rrjedhojë të kontrolluar në çdo aspekt të tij. Morfologjia e malit të kromit është totalisht e zbuluar përballë qytetit, dhe nëse ka diçka staged (prej skene të parapërgatitur) është pikërisht kjo rrugë që të çon në minierë. Vetë peizazhi e impononte kontrollin që kishin agjentët e caktuar mbi këtë peizazh, mbi punëtorët, po pa dyshim edhe mbi ne që ishim agjentë të jashtëm në të. Ishte vetë peizazhi ai që na kontrollonte. Gjatë periudhës së qëndrimit tonë në Bulqizë tentuam disa herë t'u afroheshim togjeve të kromit për t'i dokumentuar nga afër, dhe në të gjitha rastet morëm sinjale nga larg që duhet të largoheshim nga aty sa më parë. Aktorë të errët dhe problematikë kontrollonin në distancë çdo lëvizje për të mbajtur larg çdo lloj kërcënimi që i bëhej aktivitetit të tyre në minierë. Praktikisht, nëse tentoje të ngjisje

of departure, and, thus, the question you raise leads to one answer: only when the artist is able to sacrifice everything in the name of the cause and considers his/her/their work a mission, can he/she/they look miners or other marginalized communities in the eye, becoming part of their reality, and his/her/their stance will represent one in a collective gaze directed at those in power.

The conflict between the miners, the owners of the mines, the criminal underworld, and the politicians in Bulqiza is acute and relentless, creating a menacing atmosphere that seems to penetrate and envelop every aspect of life and reality, including the town's bleak landscape. Watching the miners make their way up the hill, one gets the impression that they are conscious of being watched, as if the landscape itself were watching them. Can you speak about the aspect of control and its pervasiveness in Bulqiza and how it impacted your ability to realize the project?

The winding path that the miners take on their way to the chrome mountain seemed like a predetermined trajectory, one creating a privatized landscape, subsequently controlled in every aspect of it. The morphology of the chrome mountain is openly visible to the city and, if there is something "staged," it is precisely this road leading to the mine. The landscape itself imposes control, which, in turn, certain agents hold over this landscape, the workers, and, obviously, us who were external agents. It was the landscape itself that controlled us. During our stay in Bulqiza we tried several times to approach the chrome piles to document them closely, and, on each occasion, from a distance, we received signals that we had to leave as soon as possible. Dark and troublesome actors controlled every move remotely, to discourage any possible threat to their activity in the mine. Indeed, if you tried to climb the path, like the workers, you had to be aware that you were heading towards a

rrugën, si punëtorët, duhej të merrje me vete dhe vetëdijen që po shkoje drejt një rreziku të përcaktuar qartë.

Trajtimi i punëtorëve të Bulqizës në veprën tuaj, mënyra se si kjo e fundit përshkruan realitetin e jetës së tyre të përditshme, të kujton artin e Realizmit Socialist të shekullit XX. Si e shihni të pozicionuar veprën tuaj në kuadrin e historisë së artit shqiptar dhe ç'mësime mund të nxirren nga praktikat e artit në ditët e sotme, por edhe në të ardhmen? A mund të krijohet një "art i ri popullor"?

clearly defined danger.

The way that your work portrays the workers of Bulqiza is reminiscent of socialist realist art in the twentieth century, in the way it portrays their lived, day-to-day reality. How do you see your own work in relation to Albanian art history, and what are the lessons that may be drawn from art practices today and in the future? Is there a possibility for creating a new "popular art"?

Conversation

Performanca jonë më shumë përpiqet të nxjerrë në pah përpjekjet e klasës punëtore sesa triumfin e tyre në histori dhe, ndryshe nga Realizmi Socialist i shek. XX, vepra jonë nuk drejtohet nga siguritë e Materializmit historik dhe as nga mbipërcaktimet artistike nga partia-shtet. Është e vërtetë që duam të nxjerrim në pah një figurë të punëtorit që nuk del akoma qartë, dhe ndoshta kjo përmasë e Realizmit Socialist është ende me vlerë. Kjo për faktin se arti i sotëm, ndonëse nuk drejtohet nga një ideologji e përcaktuar nga partia-shtet si në të kaluarën, vazhdon të mbetet i kontrolluar dhe i përdorur nga politika. Pikërisht politikat liberale të ndërmarra në art, sidomos në vitet e fundit, e fshijnë me dashje figurën e punëtorit nga narrativa pseudo-progresiste që duan të shpalosin.

Our performance aims to highlight the struggles of the working class rather than their triumph through history. Unlike the Socialist Realism of the twentieth century, our work is neither guided by the certainties of historical materialism, nor by the artistic guidelines dictated by the party-state. We indeed want to emphasize a figure of the worker that remains ambiguous, and, perhaps, this dimension of Socialist Realism is still valuable. This ambiguousness stems from the fact that today's art — while not driven, as in the past, by an ideology defined by the party-state — continues to remain controlled and used by politics. In recent years, it is precisely the liberal policies undertaken in art that deliberately erase the worker from the pseudo-progressive narratives they seek to display.

Biseda

Një nga kritikak më të zakonshme ndaj artit aktivist është se në përpjekjen e tij për të krijuar njëherësh edhe art edhe aktivizëm, ai dështon në bërjen e secilit në mënyrë bindëse a të kënaqshme. Megjithatë, estetizimi i skajshëm i politikës gjatë viteve të fundit duket se ka nxitur zhvillimin e artit aktivist në Shqipëri. Si e shihni këtë zhvillim në të ardhmen?

One of the criticisms routinely leveled at art activism is that by trying to do both art and activism it fails to do either in a compelling or satisfying way. Nevertheless, the extreme aestheticization of politics in recent years seems to have spurred the growth of art activism in Albania. How do you see its future development?

5
6

Roli dhe qasja e artistit në vend nuk po krijon asnjë përballje me realitetin e dhunshëm që jetojmë. Shmangia e çdo problematike e përgjegjshmërie lidhur me të, ngjan si pjesë e

The artist's role and approach to art in this country preclude any form of confrontation with the violent reality in which we live. Avoiding any issues and responsibilities related to it seems

një skenari të shkruar nga aktorët politikë në vend. Thënë kjo, aktivizmi, ndonëse ende jo fort solid, është shumë i nevojshëm. Krahasimisht me një vepër arti, rruga e tij (aktivizmit) është më e gjatë dhe rezultati është më i frytshëm. Kauza të caktuara, si ajo e Teatrit Kombëtar, do të ishin të paimagjinueshme pa përfshirjen e aktivistëve. Është për t'u theksuar se zgjatimi politik në art, si rrjedhojë e përdorimit të tij si mjet estetizimi politik, dhe si e vetmja rrugë e pranueshme e të bërit art në vend, e bën shumë të vështirë përfshirjen e artistit aktivist brenda institucioneve. Urgjente sot janë angazhimi dhe përfshirja në kauzat e marginalizuara, të cilat kërkojnë përgjegjësi individuale e kolektive, për t'iu kundërvënë fshirjes, çmontimit, mos-mediatizimit, fshehjes, korrupsionit..., që minojnë kauza të tilla, siç është dhe rasti i minatorëve të Bulqizës. Nëse dështojmë në këtë ndërmarrje dhe në konfrontimin me të tashmen, kemi paracaktuar të ardhmen shoqërore e politike të estetizuar të politikës së sotme. Hapësirat alternative, si rruga, periferia dhe realitet e marginalizuara, mbeten sot, në përvojën tonë, të vetmet procese progresiste për të kuptuar e analizuar realitetin, si edhe për ta sjellë atë në përballje me shikuesin, i cili nga ana e vet është mirë të marrë rolin e pjesëmarrësit.

A mendoni se dikur do ta shfaqni këtë projekt edhe në Bulqizë?

Absolutisht. Vetëm kështu mund të mendojmë që procesi mund të përfundojë: duke rihapur një diskutim me ta, por në një tjetër nivel. Për ta bërë këtë është e domosdoshme të krijohet infrastruktura e nevojshme, e pse jo dhe një qendër arti, ku vetë banorët të jenë përdorues të saj e ku mund të krijohen rezidenca e projekte të ndryshme lidhur me realitetet e zonës, që të përfshijnë artistë të tjerë, të zonës, por edhe të ardhur.

like part of a screenplay written by the country's political actors. That said, activism, though not solid presently, is necessary; its path may be longer, but the result is more effective than that of a work of art. Specific causes, like that of the National Theater, would be unimaginable without the involvement of activists. It should be noted that the political extension of art resulting from its use as a means of political aestheticization, having become the only "acceptable" way of making art in the country, makes it very difficult to include activist art within the state institutions. What is exigent today is the engagement and involvement in marginalized causes that require individual and collective responsibility towards erasure, dismantling, the lack of media coverage, concealment, corruption, all of which undermine issues like that of the miners of Bulqiza. If we fail in this enterprise and do not confront the present, we will have predetermined the aestheticized political and social future of today's politics. Alternative spaces — the street, the periphery, and marginal realities — remain today, in our experience, the only progressive processes that serve to understand and analyze reality and confront the viewer with it. The audience, in turn, should take on the role of the participant.

Do you intend to eventually show this project in Bulqiza as well?

Absolutely. Only then, by reopening a discussion with them, but on another level, may we think that the process can end. For this aim, it is indispensable to create the necessary infrastructure, and, why not, an art center with the residents as its users, and where local artists and invited ones, as well, can be included in residences and various projects addressing the realities of the area.

KUSH ËSHTEË KUSH

WHO IS WHO

Vincent W.J. van
Gerven Oei

Botues
Publisher

botues dhe nubiolog. Ai bashkëdrejton shtëpia botuese “open access” punctum books dhe themelues i Departamentit e Shqiponjave. Ai ka botuar shkrime mbi artin shqiptar në *Afterall* dhe *ArtPapers*. Një përzgjedhje sprovash, *Arti, korrupsioni dhe fundi i tranzicionit shqiptar*, pritet të botohet nga Pika pa sipërfaqe në Tiranë.

is a publisher and Nubiologist. He is co-director of open access press punctum books and founder of The Department of Eagles. He has published writings on Albanian art in *Afterall* and *ArtPapers*. His collection of essays *Arti, korrupsioni dhe fundi i tranzicionit shqiptar* is forthcoming with Pika pa sipërfaqe in Tirana.

Jonida
Gashi

Kulturologe
Cultural theorist

kulturologe e interesuar për përkohshmërinë e filmit dhe video-artit dhe për përvojën artistike të periudhës postkomuniste në Shqipëri. Aktualisht ajo është Kryetare e Departamentit të Studimeve të Artit në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe të Studimit të Artit në Tiranë (Akademia e Studimeve Shqiptare).

is a cultural theorist working on the temporality of contemporary film and video art and the artistic experience of post-communism in Albania. She is currently Chair of the Department of Art Studies at the Institute of Cultural Anthropology and the Study of Art in Tirana (Academy of Albanian Studies).

Blerta
Hoçia

Artiste/Kuratore
Artist/Curator

kuratore e pavarur. Ka punuar si kuratore në Galerinë Miza (2014–2016), një hapësirë artistike e pavarur në Tiranë, si edhe ka drejtuar Arkivin në Muzeun Kombëtar të Fotografisë Marubi në Shqipëri (2017). Në praktikën e saj artistike ajo fokusohet në procesin krijues të kujtesës (si e trajtojmë atë në zona intime dhe si shoqëri) kryesisht duke punuar me arkivat personale si dhe me arkivat publike dixhitale apo analoge.

independent curator. She was a curator at Miza Gallery (2014–2016), an artist run space in Tirana and from 2016 the Head of the Archive at Marubi National Museum of Photography in Albania (2017). In her artistic practice she focuses in the creative process of memory, how we deal with it in the intimate and as a society, mainly working with personal archives as well as with digital or analogue public archives.

Ergin
Zaloshnja

Artist/Aktivist
Artist/Activist

Diana
Malaj

Avokate/Aktiviste
Lawyer/Activist

është një artist vizual dhe aktivist i cili aktualisht jeton dhe punon në Tiranë. Përveç mediave të tij parësore - fotografisë, instalacionit dhe videos - ai ka zhvilluar një seri ndërhyrjesh artike në rrugë me pseudonimin "Diver Santi". Gjithashtu, ai është themeluesi i fanzinës politike subkulturore "Sputnik" dhe anetar i D.C.C.A, Qendra e Artit Bashkëkohor Debatik, Tiranë.

is a visual artist and activist who currently lives and works in Tirana. In addition to his primary media — photography, installation and video — he has developed a series of street art interventions under a pseudonym "Diver Santi". He is also the founder of the political and subculture zine *Sputnik* and a member of the D.C.C.A, the Debatik Center for Contemporary Art, Tirana.

është një nga themelueset e grupit aktivist ATA, i cili ka si prioritet luftën për përdorimin e hapësirave kulturore në qytetin e Kamzës. Diana është avokate dhe aktiviste e përqëndruar në drejtësinë sociale. Angazhimin e saj si të tillë e ka filluar me mbrojtjen e të drejtave kulturore dhe sociale në periferi.

is one of the founders of ATA, an activist group defending the right of public spaces in the city of Kamza to be used as cultural venues. Diana is a lawyer and an activist focusing on social justice. She started her engagement as such with the protection of cultural and social rights in the suburbs.

Pleurad
Xhafa

Artist/Aktivist
Artist/Activist

është një artist vizual dhe aktivist , i cili jeton dhe punon në Tiranë. Ai studioi në Akademinë e Arteve të Bukura në Bolonja, ku u diplomua në vitin 2012 me një MPJ në Arte Pamore. Ai është një nga themeluesit e Qendrës së Artit Bashkëkohor Debatik.

is a visual artist and activist based in Tirana. He studied at the Academy of Fine Arts in Bologna, where he graduated in 2012 with an MFA in Visual Arts. He is one of the founders of the D.C.C.A, the Debatik Center for Contemporary Art.







ED

Vincent, ti e ke ndjekur nga afër aktivitetin e këtij grupi artistësh të përfshirë në këtë projekt, por edhe të tjerë që kanë një zë kritik ndaj zhvillimeve në vend. Ti thua që një art, në kushtet e Shqipërisë, nuk mund të jetë veçse politik. Drejt ç'rwege po shkon skena e artit të pavarur në Shqipëri, dhe çfarë mund të ndryshojë përpjekja e këtyre njerëzve?

VGO

Më ka bërë përshtypje ky projekt, sepse ka qenë jashtë Tiranës. Nuk ndodh shpesh që artistët që punojnë brenda Tiranës, të shkojnë së bashku në një vend tjetër brenda Shqipërisë për të bërë një vepër artistike. Në këtë moment duket se skena e artit në Shqipëri është e mbytur, e përmbysur, nuk po merr frymë. Dhe fiks në këtë moment ata dalin jashtë.

Do të doja të flisja pak për çështjen e artit popullor. Kjo është një çështje e lidhur me artin e realizmit socialist, me komunizmin. Kjo vepër që po realizohet në Bulqizë si pjesë e projektit *MINERAL POLICIES* është tentativë për të arritur tek arti popullor, është sprovë shpresëdhënëse – sado që varet nga rezultati – se si mund të arrihet në atë pikë që të lidhë artin me njerëzit, me popullin, me qytetin, me fshatin, me komunitetin.

ED

Vincent, you have followed closely the activity of the group of artists involved in this project, but also that of others who have assumed a critical stance towards the developments in the country. You say that art, in contemporary Albania, can only be political. Where is the independent art scene in Albania heading, and what can the efforts of these people change?

VGO

This project made an impression on me, as it took place outside Tirana. It's not common for artists who work in Tirana to get together and travel to another area of the country to create a work of art. Presently, the art scene in Tirana seems suffocated, inverted, not breathing. And, precisely at this moment, they step outside. I would also like to address the issue of folk art. This subject is closely linked to the art of Socialist Realism, to communism. This work that is being created in Bulqiza, as part of the *MINERAL POLICIES* project, represents an effort to approach folk art, and a hopeful attempt, albeit one that depends on the result, on how it can connect art with people, the city, the village, the community.



ED

E ndoqa një mëngjes herët një pjesë të performancës në Bulqizë dhe një natë ndoqa diskutimin e katër autorëve. Ata ishin të shqetësuar në një pikë: “Ne po vijmë në një vend ku nuk jetojmë, nuk e njohim plotësisht dramën e këtij komuniteti, ndihemi si turistë këtu. A do transmetojë puna jonë diçka thelbësore nga ky komunitet?”

VGO

Kjo është sfidë edhe për ata që krijojnë në Tiranë. Artistit i ndodh që të ndihet turist edhe në qytetin e vet. Vetëm se në Bulqizë kontrasti është më i madh. Jam i sigurt që në këtë punë ka disa mësimë që vlejnjë për skenën në përgjithësi, p.sh. si mund të lidhet arti me shoqërinë. Sipas meje kjo pyetje është nga më të rëndësishmet tani kur arti po instrumentalizohet nga qeveria, nga klasa sunduese, në një mënyrë që nuk ka të bëjë të paktën me artin që unë pëlqej.

ED

Kemi artistë që e kanë orientuar kërkimin e tyre në këtë kahje, ndërkohë që shteti ndjek një politikë të centralizuar në drejtim edhe të artit bashkëkohor. Kemi një sallon arti në Kryeministri (COD – Center for Openness and Dialogue), dhe po së fundi kemi edhe një sallon arti (Pavioni) në hollin e Ministrisë së Kulturës. Nën shembullin e Kryeministrit, edhe Ministrja e Kulturës ka hapur sallonin e vet të artit, në një vend ku janë zyrat vendimarrëse të shtetit tonë...

VGO

Ky është, në fund të fundit, arti propagandë që bën qeveria. Atëherë ne duhet të mendojmë si të bëjmë art- propagandë për popullin. Unë jam i idesë që arti nuk mund të jetë propagandistik. Patjetër që gjithmonë ka një aspekt politik brenda çdo lloj arti, po varet se çfarë lloj politike. Dhe një art që propagandon këtë

ED

I had a chance to catch an early performance in Bulqiza one day, and, on another night, I attended a discussion among the four authors. They were mainly concerned about one aspect: “We are coming to a place where we do not live; we are not wholly familiar with the drama of this community; we feel like tourists here. Will our work convey something of the essence concerning this community?”

VGO

This is no less of a challenge for those who create in Tirana. An artist can feel like a tourist even in their own city. Certainly, in Bulqiza, the contrast is greater. I believe that this particular work offers valuable lessons for the art scene in general, specifically regarding the link between art and society. I believe that this is one of the most important issues at the present moment, when art is being instrumentalized by the government, the ruling class, in a way that has nothing to do with art — at least the kind of art that I like.

ED

Some artists have taken their research in this direction, while the state also pursues a centralized policy towards contemporary art. The building housing the office of the Prime Minister includes an art salon (COD – Center for Openness and Dialogue), and recently an art salon (The Pavilion) was set in the lobby of the Ministry of Culture. Following the Prime Minister’s example, the Minister of Culture opened her art salon as well, and in the same location as the decision-making offices of our state...

VGO

This is, after all, the propaganda art produced by the government. Therefore, we have to think about how to create propaganda art for the people. I believe that art is always a kind of propaganda. There is always a political aspect within any art; only the type of politics changes. Art that endorses this government — with these policies — is worthless, in my opinion.

qeveri dhe çdo qeveri, është i pavlerë.

GM

Doja të shtoja diçka. Unë kam punuar me ekipin e minatorëve nën tokë. Pavarësisht rrezikut që mund të mos kthehesh në shtëpi, ajo që është e veçantë te minatorët, edhe te naftëtarët, është se ekziston mes tyre një lloj solidariteti njerëzor që në zanate të tjera unë nuk e kam parë. Mbjaj mend që kur u emërova në vitin '85 në Bulqizë, si inxhinier mekanik, kam kaluar mirë. Punohej 24 orë, kishte shumë vështirësi, po kishte një kulturë të theksuar solidariteti. Kjo është një vlerë shumë e madhe. Uroj që artistët ta kenë perceptuar këtë fenomen gjatë qëndrimit të tyre në Bulqizë.

VGO

Në Galerinë Kombëtare të Arteve ka një ekspozitë me gjithë veprat e fondit të Galerisë. Shumica e veprave janë trashëgimi nga periudha e realizmit socialist. Çfarë më bën përshtypje nga veprat e realizmit socialist është stili “realist” i pikturimit. Një pyetje që duhet të shtrojmë është: A mund të bëjmë një lloj arti të realizmit socialist të sotshëm?

ED

Nëse artistët duan të shtojnë diçka, janë të mirëpritur.

Blerta Hoçia (BH)

Është e vërtetë që ne kemi pasur dyshimet tona gjatë këtij procesi, ne që vijmë nga Tirana, duke e konsideruar veten disi të privilegjuar dhe i qasemi për një periudhë të shkurtër atij komuniteti. Gjatë kohës që ju (AM) flisnit vërtitej një pyetje në mendje: Pse akoma sot, nuk miratohet statusi i minatorit?

AM

E para, minatorët kanë pasur një status të veçantë, që ka të bëjë me pagat dhe moshën e daljes në pension. Ka qenë historikisht. Fjala “status” keqkuptohet sepse çdo parti politike dhe çdo individ thotë “status”. Statusi nënkupton se si do të jenë raportet e tyre në pagat, në mbrojtjen sociale dhe sigurimet shoqërore.

GM

I'd like to add something here. I have worked underground with the mine workers. What is unique about mine workers in particular, and even oil workers, is that (despite the potential risk of possibly not returning home) there is a kind of human solidarity among them that I have not witnessed in other professions. I remember that, when I was appointed a mechanical engineer in 1985 in Bulqiza, I had a good time. We worked 24 hours a day, and there were many difficulties, but there was a strong sense of solidarity, which is invaluable. I hope that the artists could detect this phenomenon during their stay in Bulqiza.

VGO

At the National Gallery of Art, there is an exhibition displaying all of the works from its collection. The majority of the artworks are the legacy of the period of Socialist Realism. What impresses me about the art of Socialist Realism is the “realistic” painting style. One question we have to ask is: can we make some kind of Socialist Realist art today?

ED

If the artists would like to add something, they are welcome to.

BH

It is true that we, who come from Tirana — considering ourselves somewhat privileged and being amid this community for a short time — have had our doubts during this process. While you (AM) were speaking, a question was running through my mind: Why is the mine worker status still not approved today?

AM

First of all, mine workers have had a special status regarding their wages and retirement age. It has been this way throughout history. The word “status” is misunderstood because every political party and individual uses this term. The status denotes what their ratios will be in terms of wages, social protection, and social security. When the communist regime

Kur ra regjimi komunist, vendet u ndanë në dy grupe: ato që ndryshuan sistemin politik, siç janë vendet e reja anëtare të Bashkimit Europian, dhe nuk e shkatërruan sistemin publik dhe administratën publike. Dhe vende si Shqipëria, Rumania dhe Ballkani, që ndryshuan sistemin politik nën teorinë e “shock therapy”, duke shkatërruar edhe fizikisht sektorin publik. Problemi më i madh që ne kemi pasur, kur unë kam qenë Ministër i Financave, është abuzimi me djegien e arkivave, ku rezultonte me status minoritari ai që s’kishte qenë asnjë ditë minoritar. Kur rriten shifrat në mënyrë abuzive, dhe kur këta (*vendos dorën mbi shpatullën e Bardhulit*) nuk i dalin zot vetes për shkak të njëqind arsyeve, atëherë shteti jep një status edhe për ata që mund të jenë 50% në totalin e njerëzve që kërkojnë status. Kur në pozitën e njeriut që ke të bësh me financat publike, ti ke parasysh ata fëmijë që shkojnë në shkollë, ke dritat, ujin, shëndetësinë...

GM

Është statusi i naftëtarit, i invalidit, dhe të gjitha këto statuse do paguhen nga fitimet që nxjerrin kompanitë private...

AM

Jo, pronarët janë tjetër gjë. Do paguhen nga taksapaguesit shqiptarë. Ato para shteti do t’i përdorë për drejtime shumë prioritare. Statusi nuk është gjë e lehtë edhe në vende të zhvilluara, kurse populizmi që bëhet me statusin është më i dëmshëm. Edhe për moshat e pensionit të minoritëve ka studime në botë. Moshat e pensionit të tyre në komunizëm ka qenë favorizuese. Prandaj po të bëhen studime të qyteteve minerare dhe naftëtare për moshën mesatare dhe sëmundjet profesionale, do shikojmë që ata realisht kanë nevojë për status të veçantë. Ta bësh e të mos e realizosh për mungesë të burimeve financiare, do të thotë që

fell, the Eastern European countries split into two groups. On the one hand, there were those that changed their political system, like the new member states of the European Union, without destroying the public system and public administration. The other group includes countries like Albania, Romania, and the rest of the Balkans, which changed the political system following the ‘shock therapy’ theory, physically destroying the public sector. When I served as a Minister of Finance, the biggest problem we faced was the burning of the archives, which resulted in phenomena like: someone possessing the mine worker status without having been a mine worker one single day in his life.

When the numbers increase in an abusive manner, and when they (*placing his hand on Bardhul’s shoulder*) cannot look after themselves for countless reasons, the state gives a status even to those who may represent fifty percent of the total number of people seeking the status. When one is in a position dealing with public finances, one thinks of the children going to school, of electricity, water, health...

GM

It is the status of the oil workers, the handicapped... and all these statuses will be paid from the earnings made by private companies.

AM

No, owners represent another issue. Albanian taxpayers will pay them, and the state will use that money for priorities. The question of status is not a simple thing even in developed countries, and the populism of status is even more harmful. Studies on the retirement ages of mine workers exist in the world. During the former communist regime, their retirement age was favorable. Therefore, if we conduct studies concerning the median age and professional diseases in mining and oil cities, we will see that the workers in these fields need a special status. To reach this conclusion, and not implement it for lack of financial resources, means committing another crime.

të bësh një krim tjetër.

GM

Në kohën e komunizmit nuk quhej status, por ata e kishin një lloj mbrojtjeje, merrnin ushqim që quhej antidot, merrnin qumësht, etj.

AM

Ka një studim austriak që tregon se në vitin 1911, kur Shqipëria nuk kishte akoma shtet, të ardhurat në raport me 15 vende të zhvilluara në Evropë ishin 25%. Në vitin '90, kur ra sistemi komunist, ato ishin 18%. Kuptoni sa të vështira janë këto procese?

Kush nuk ka dëshirë? Unë jam rritur në një familje me 9 fëmijë, kam punuar në bujqësi, kam përshkuar 17 km rrugë në këmbë për të shkuar në shkollë, po nuk e premtoj dot, se ato para duhet t'ia marr dikujt tjetër: o do ja marr arsimit, o do ja marr shëndetësisë. Kështu që kërkesat duhet të jenë të arsyeshme, dhe këta vetë (*tregon nga BA*) duhet të përjashtojnë çdo rast abuzimi. Kështu që nuk është se nuk do qeveria, pavarësisht se kush është kryeministër.

BH

Pavarësisht se premtohet vazhdimisht? Atëherë është gënjeshtër.

AM

Shiko, e di sa e lehtë është të flasësh kështu, siç po flet ti tani? Jo, kjo s'është gënjeshtër, është përgjegjshmëri. I vetmi deputet në zonën e Bulqizës që e ka premtuar dhe ka dhënë dorëheqjen ka qenë Ismail Lleshi, që është shembull pozitiv. Shkoi atje me premtimin e Kryeministrit Meta, për rrugët, për minierën dhe për shkollat. U bë qeveria, Kryeministri tha "nuk i bëjmë dot", atëherë ai dorëzoi mandatin, tha "më falni që unë ju gënjeva, sepse premtova në bazë të Kryeministrit". Jo, nuk është kaq e lehtë, se ju gjithçka e bëni bardh-e-zi me fjalë.

GM

During the former communist regime, it wasn't called a "status," but they had some sort of protection. They had food, which was considered an "antidote," milk, etc.

AM

There is an Austrian study showing that, in 1911, when Albania was not yet a state, its income, when compared to fifteen developed European countries, was 25%. In the 1990s, when the communist system fell, it was 18%. Do you understand how difficult these processes are?

Who wouldn't want to? I grew up in a family with nine children; I have worked in agriculture; I used to walk seventeen kilometers to get to school. Yet, I cannot promise anything because that money is not mine and it must come from someone else: either the education or health sector. So, the demands must be reasonable, and they (*points to BA*) must rule out any abuse. Thus, it is not a matter of the government not wanting to do it, no matter who the Prime Minister is.

BH

Despite constant promises? Then, it is a lie.

AM

Look, do you know how easy it is to speak the way you are speaking right now? No, it is not a lie, but it is about being responsible. The only MP in the Bulqiza area, who promised it and resigned, was Ismail Lleshi — a positive example. He went there to fulfill the promises made by prime minister Ilir Meta regarding roads, the mine, and schools. After the government was formed, the prime minister stated that "we cannot do it," and Lleshi handed over the mandate. He said: "Forgive me for lying to you, but my promises were based on the words of the prime minister." No, it's not as simple and as black and white as you make it.



Pleurad Xhafa (PXH)

Nuk është e lehtë, po nga eksperiencia jonë në atë qytet, situata është shumë bardh-e-zi, mafia është dominante...

AM

Ju po thoni ato që thashë unë, po s'jam unë përgjegjës për luftën kundër krimit. Ju thoni që gjithë "e zeza" është te politika. Unë them është te shoqëria. Ka disa aksionerë, janë besimet fetare, është shoqëria civile, janë shoqata të ndryshme... Ju po drejtoni gishtin nga grupi që atakohet më kollaj publikisht.

PXH

Ata që administrojnë minierat janë ish-kryetarë bashkish, janë ish-deputetë...

AM

Janë oligarkët, pse ke frikë ta artikulolesh? Po munde, nxirri oligarkët me emra në këtë takim...

ED

"Albchrome"-i administrohet nga njeriu më i pasur i shtetit shqiptar, Samir Mane.

AM

Unë kam në një takim tjetër tani. (*Shikimi tek ora e dorës.*) Ju uroj gjithë të mirat! (*Në ikje i drejtohet PXH*) Të rri unë të dëgjoj akoma ty

Pleurad Xhafa (PXH)

It's not simple, but — from our experience in that town — the situation is black-and-white: the mob rules everything...

AM

You are saying the same thing as I am, but I am not responsible for the war against crime. You are claiming that the 'black' comes from politics. I claim it comes from society. There are several actors, religious beliefs, civil societies, various organizations... You are pointing the finger at the group that is easiest to attack publicly.

PXH

Those who administer the mines are former mayors, former deputies...

AM

They are the oligarchs. Why are you afraid to spell it out? If you can, name the oligarchs during this meeting...

ED

The AlbChrome company is headed by the wealthiest Albanian citizen, Samir Mane.

AM

I have another meeting. (*Checks his watch.*) I wish you all the best! (*As he leaves, he addresses PXH.*) Why should I stay and listen to you only blaming us?! Learn how to hold yourself accountable!



Vijon në faqen

Continues on page

**EACH
STRIKE**

LEADS
THE TO
NEXT

Çdo goditje pason tjetrën

Blerta Hoçja
Diana Malaj
Pleurad Xhafa
Ergin Zaloshnja

Një pas një, të gjitha regjimet në Shqipëri janë joshur nga ideja e shfrytëzimit të depozitave të kromit të Bulqizës, që si një gjuhë gjigande e argjenditë lëpin brendësinë e malit. Ndërsa gjatë periudhës komuniste, të burgosurit detyroheshin të punonin në miniera dhe puse zhytur thellë në koren e tokës, tranzicioni ende në vijim drejt demokracisë ka sjellë në rajon eksceset më të këqija të kapitalizmit neoliberal. Dhjetra kompani – prona jo vetëm të oligarkëve si Samir Mane, por edhe të anëtarëve të parlamentit, kryetarëve të bashkive, prokurorëve dhe familjeve të tyre – konkurrojnë në një garë drejt “fundit”, në kuptimin e parë të fjalës, përtej çdo përgjegjshmërie dhe kontrolli të qeverisë, pa protokolle sigurie zbatuar sipas rregullave, si dhe pa paguar siç duhet punonjësit e tyre, minatorët e Bulqizës. Këta të fundit nuk përfitojnë asgjë nga pasuritë që nxjerrin çdo ditë në sipërfaqe, pasi për pushtetarët, përveçse gjatë periudhës së shkurtër të zgjedhjeve, territori i tyre është i padukshëm.

Each Strike Leads to the Next

Blerta Hoçja
Diana Malaj
Pleurad Xhafa
Ergin Zaloshnja

Like a massive silver-grey tongue licking the inside of the mountain, the chrome deposits of Bulqiza have tempted successive Albanian regimes to exploit its riches. While during the communist period, prisoners were forced to work the mine shafts and wells diving deep into the earth’s crust, the still ongoing transition to democracy has brought the worst excesses of neoliberal capitalism to the region. Dozens of companies – not only owned by oligarchs such as Samir Mane, but also members of parliament, mayors, prosecutors, and their family – compete in a literal race to the bottom, beyond accountability and government control, without properly enforced security protocols, without even properly paying their employees, the miners of Bulqiza. The latter see nothing of the riches that they bring to the surface every day, as their region is invisible to those that hold power, except in the brief windows of election time.

Asgjë nga pasuritë, por të gjitha mundimet. Më 20 shtator 2021, trupi i pajetë i minatorit 60-vjeçar Muharrem Plaku u gjet në Galerinë Nr. 3. Minator me përvojë, ai u asfiksua ngadalë, përgjatë pesë ditëve. Pavarësisht premtimeve të pafuqishme të operatorit të minierës së kromit dhe kryebashkiakut të Bulqizës, Lefter Alla, për ta nxjerrë Plakun ende të gjallë, mungesa e një ekipi me profesionistë kërkim-shpëtimi bëri që shpresa të ishte e vogël që në pikënisje. Edhe pse pati një hetim fillestar ndaj kompanisë “KADURTEX” Sh.p.k. që operonte në këtë galeri, historia ishte e parashkruar: përgjegjësia e individit, mosrespektimi i protokolleve të sigurisë. Kompania nuk është asnjëherë fajtores. Në rrugët e fshatit, rojet e operatorëve kryesorë lëviznin në mënyrë kërcënuese, duke monitoruar çdo shenjë të mbetur rezistence a proteste. Mercedesët e tyre të zinj e plot shkëlqim krijonin një kontrast të fortë me sipërfaqen e pluhurosur të blloqeve të banimit.

Nothing of the riches, but all of the burdens. On September 20, 2021, the lifeless body of 60-year-old miner Muharrem Plaku was recovered from Gallery no. 3. An experienced miner, he slowly suffocated to death for five days until he was found. Despite the impotent words of chrome mine operator and Bulqiza mayor Lefter Alla to bring Plaku out alive, the absence of a professional search and rescue team meant that there was little hope from the beginning. Although an investigation was started against the company operating the gallery, “KADURTEX” sh.p.k., the story had already been written: individual responsibility, not following safety protocols; the company is never to blame. Down in the village, the enforcers of the major operators moved menacingly through the streets, monitoring any lingering sense of resistance or protest, their polished, black Mercedeses starkly contrasting with the grey-dusted housing blocks.

Si është e mundur të krijosh art në një situatë të tillë?

Kjo ishte pyetja e vështirë me të cilën u përballën

Blerta Hoçia, Diana Malaj,

Pleurad Xhafa dhe Ergin

Zaloshnja teksa mbërrinin

në Bulqizë, më pak se 24

orë pas vdekjes së Plakut.

Përgjigjja e tyre për këtë

pyetje bart një rëndësi

që shkon përtej lidhjes

së saj të drejpërdrejtë

dhe të menjëhershme me

kontekstin e Bulqizës.

In such a situation, how is it possible to make art? This was the difficult question that Blerta Hoçia, Diana Malaj, Pleurad Xhafa, and Ergin Zaloshnja were faced with as they arrived in Bulqiza, less than 24 hours after Plaku's death. Their answer to this question has an importance that goes beyond its immediate relevance to the context of Bulqiza.

Së pari, ishte vendimi i tyre për t'u kolektivizuar. Duke braktisur veprimtaritë e tyre vetjake si artistë në hapësirën publike, apo si dizajnerë, fotografë, kuratorë dhe aktivistë të çështjeve sociale (pak rëndësi kanë titujt e tyre), ata vendosën të prodhonin një punë kolektive. Ky gjest bart një kuptim të veçantë në kontekstin e Bulqizës, minatorët e së cilës kanë bërë përpjekje të mëdha për të formuluar kërkesa kolektive dhe për t'u organizuar në një sindikatë, e cila të mund të përfaqësojë vërtet interesat e tyre, në vend se të jetë një zgjatim i klasës së oligarkëve: klasa politike që sundon minierat, klasa që kërkon “paqe absolute”. Një sindikatë e re, e themeluar vetëm pak vite më parë, operonte nën kërcënimet e vazhdueshme të kompanive minerare dhe të qeverisë Rama, qeveri e cila krenohet me “mungesën e sindikatave” në territorin shqiptar.

First, it was their decision to collectivize. Abandoning their individual practices as artist in public space, designer, photographer, curator, or social activist (it is irrelevant who was what), they decided to produce work collectively. This gesture is meaningful in a place where miners have struggled to formulate collective demands and organize in a union that truly represents their interests, rather than being an extension of the oligarchic, political class that dominates the mines, a class that demands “absolute peace.” A new union, founded some years back had to operate under constant threats of the mining companies and the Rama government, which prides itself in the “absence of unions” on Albanian territory.

Së dyti, artistët vendosën të ofrojnë një kanal për një besnikëri të mundshme. Besnikëria, sipas filozofit francez Alain Badiou, është një proces subjektiv përmes të cilit e vërteta e një ngjarjeje rikujtohet dhe rindërtohet në kohë dhe hapësirë. Ngjarja, në këtë rast, është rezistenca e suksesshme e minatorëve në mbarë botën kundër forcave dehumanizuese të materializmit demokratik, në të cilin marrëdhëniet e vetme janë ato të pushtetit. Një ide kjo e mirëartikulluar në vetë titullin e veprës, *Çdo goditje pason tjetrën*.

Second, the artists decided to offer a channel to a possible faithfulness. Faithfulness, according to the French philosopher Alain Badiou, is the subjective process through which the truth of an event is recalled and reenacted across time and space. The event, in this case, is the successful resistance of miners around the world against the dehumanizing forces of democratic materialism, in which the only relations are power relations. This is already precisely articulated in the title of the work, *Each Strike Leads to the Next*.

Në veprën e tyre, artistët renditin grevat e suksesshme të minatorëve në mbarë botën, si edhe kontekstet përkatëse të secilës grevë, kontekste këto të përtafërta me atë të Bulqizës. Lista e grevave është e shkruar në letrën mbështjellëse të dinamitit të përdorur në shpërthimin e malit. Teksti është shpërthyes. Duke lexuar listën kronologjike gjatë katër mëngjeseve të njëpasnjëshëm, ne bëhemi dëshmitarë edhe të zhdukjes së ngadaltë të artistit. Në videon e ditës së parë, shohim Malajn teksa mbërrin dhe nis leximin e tekstit përballë kamerës. Videot e ditës së dytë dhe të tretë, me artistët Zaloshnja dhe Hoçia, i shfaqin këta artistë në një kënd të ngushtë, ndërsa në videon e mëngjesit të katërt dhe të fundit, Xhafa është fillimisht i padukshëm ndërsa minatorët ngjiten në mal duke vështuar drejt kamerës. Një pamje e dytë zbulon vendndodhjen e tij në sfondin e luginës së Bulqizës, ndërsa sekuenca e tretë të çon tek minatorët që ecin drejt kamerës me Xhafën përsëri në sfond, duke zbritur malin. Ajo çka dallohet në mënyrë të veçantë në këtë seri videosh është zbulimi gradual i pranisë së artistëve nga punëtorët gjatë katër mëngjeseve, por edhe zëvendësimi gradual i artistëve nga punëtorët si subjekt i videove. Thua vërtet disa nga kufijtë mes artistit dhe minatorit zhduken.

Nuk duhet të gabojmë e ta quajmë këtë vepër “frymëzuese”. Fjalët e artistëve nuk frymëzuan ndonjë grevë e nuk ndezën ndonjë flakë rezistence. As vështirësitë me të cilat përballen ata pak artistë shqiptarë që duan të ngrenë zërin kundër uzurpimit kriminal të sferës publike nga një pakicë e vogël dhe e fuqishme, nuk mund kurrsesi t’i krahasojmë me vështirësitë fizike me të cilat përballen ata që rrezikojnë jetën e tyre çdo ditë.

In their work, the artists read off a list of successful miner strikes across the world, and the contexts in which these strikes happened – contexts of corruption and repression very close to the one in Bulqiza. The list is printed on the paper wraps of the dynamite used to blow up the mountain. The text they contain is explosive. Reading through the chronological list on four consecutive mornings, we witness also the gradual vanishing of the figure of the artist. In the video of the first day, we see Malaj arriving and reading the text facing the camera. The videos of the second and third day, featuring Zaloshnja and Hoçia respectively, feature the artists at an oblique angle, while on the video of the fourth and final morning, Xhafa is initially invisible as the miners file up the mountain while looking straight into the camera. A second shot shows him against the background of the Bulqiza valley, whereas the third shot cuts back to the miners walking toward the camera, Xhafa descending the mountain on the background. What is remarkable in this series of videos is both the gradual acknowledgment of the presence of the artists by the workers across the four mornings, but also the displacement of the artists by the workers as subject of the videos. As if, indeed, some of the borders between artist and miner were erased.

We should not make the mistake to call this work “inspirational.” The words spoken by the artists did not inspire any strike, nor did they light any flame of resistance. Nor should we consider the difficulties faced by the few Albanian artists that wish to raise their voice against the criminal usurpation of the public sphere by a small and powerful minority as comparable to the physical hardships faced by those who risk their lives every day inside the mountain.

Për të rikthyer në skenë një term tashmë të vjetëruar, *Çdo goditje pason tjetrën* është një vepër soc-realiste në mënyrën se si ajo paraqet njëkohësisht realitetin që përjetojnë minatorët e Bulqizës, por edhe potencialin e brendshëm revolucionar të këtij realiteti. Në këtë kuptim, *Çdo goditje pason tjetrën* i përgjigjet prerazi dekorit, të financuar nga paratë e pista, që zbukuron postimet në Instagram të elitës politike dhe shoqërore shqiptare, kotësinë patetike të së cilës e tejkalon vetëm zbrazëtia e saj intelektuale.

To reuse a perhaps antiquated term, *Each Strike Leads to the Next* is a socialist realist work, in that it portrays the lived reality of the miners of Bulqiza while also recalling its inherently revolutionary potential. In this sense, *Each Strike Leads to the Next* is a firm response to the dark-money-funded decorations featured as the backdrop to the Instagram posts of the Albanian political and social elite, their pathetic irrelevance only surpassed by their intellectual vacuity.



Çdo goditje pason tjetrën
Dokumentim i performancës n.1
—
Each Strike Leads to the Next
Documentation of performance no.1
—
Diana Malaj

Fragment nga videoja
Video still

Çdo goditje pason tjetrën
Dokumentim i performancës n. 2

—

Each Strike Leads to the Next
Documentation of performance no. 2

—

Ergin Zaloshnja



The constant clashes between protesters and Franco's police and army were so violent that the streets of Asturias turned into a guerrilla battlefield.

Fragment nga videoja
Video still

Çdo goditje pason tjetrën
Dokumentim i performancës n. 3

—

Each Strike Leads to the Next
Documentation of performance no. 3

—

Blerta Hoçia




Fragment nga videoja
Video still



The fight for the rights of the miners of Escondida is still going on . . .

Fragment nga videoja
Video still

Çdo goditje pason tjetrën
Dokumentim i performancës n. 4
—
Each Strike Leads to the Next
Documentation of performance no. 4
—
Pleurad Xhafa



e on July 21st, 2011,
otiations were put on halt.



Il titolo "Il mio paese" è un riferimento
al titolo del film "Il mio paese" di
1961, diretto da Giuseppe De Santis.
Il film è un documentario che racconta
la vita di un villaggio di pescatori
in Sicilia. Il titolo è un riferimento
al titolo del film "Il mio paese" di
1961, diretto da Giuseppe De Santis.
Il film è un documentario che racconta
la vita di un villaggio di pescatori
in Sicilia.




Që Bulqiza të fitojë mbi skllavërinë
Materiale të ndryshme, 2011–2021

—
That Bulqiza Triumphs over Slavery
Mixed media, 2011–2021

Artikull gazete në gjuhën shqipe, kornizë
druri e personalizuar (*gjetur në njëërën
nga shtëpitë e braktisura të fshatit Zogjaj,
28 km larg qytetit të Bulqizës. Fshati
Zogjaj numëronte rreth 115 banorë të cilët
janë larguar përfundimisht gjatë viteve
të fundit. Banori i fundit është larguar në
maj, 2021*)

—
Albanian newspaper, customized wooden
frame (*found in one of the abandoned
houses of the village Zogjaj, 28 km away
from Bulqiza town. Zogjaj had about 115
inhabitants who have abandoned their
village in recent years. The last resident
has left in May 2021*)



...labirinth nëntokës, ku po
kombëtrohet një pasuri e terrë
një grusht barbarësh të veshur
me pushtet a të mbrojtur nga
pushteti. Kompania e përfshirë
në këtë mesele të zymtë s'është
veçse një tentakulë e oktapodhit
në maflas së minierave, që po i
n Shqipërisë atë që s'do t'ia
në kurrë asnjë pushtim, që
at je e je në periudhat e sun-
në të kurrë të pamëshirshëm.
...e tyre të minator të thos-
...e tyre të minator të thos-
...e tyre të minator të thos-

...rivendosur ligji për
rendin e shërbimeve
e ministrit të tij duket
Rama na e alarmit
Saliu mesa duket e
atë firmë, e di ai me
ashtu sic duket se e g
ligjshmëria dhe ky re
rie në nëntokën e Bu
bekimin e tij të plotë,
përkates sigurisht, nd
asnjë shpjegim tjetër.
...e Republik






Cinque giorni (1971)

Il video "Cinque giorni" (1971) di Pierluigi Corbelli è un'opera che esplora il tema del tempo e della memoria. L'artista utilizza immagini in movimento per raccontare una storia personale e collettiva, attraverso una serie di scene che si susseguono in un ritmo lento e meditativo. L'opera è caratterizzata da una palette cromatica dominata dal blu, che contribuisce a creare un'atmosfera di quiete e riflessione. Il titolo "Cinque giorni" si riferisce al periodo di tempo in cui l'artista ha raccolto le immagini e le storie che compongono l'opera.





According to the miners' union,
with 2164 votes in favor and 11 against



Pa titull
Materiale të ndryshme, 2021
—
Untitled
Mixed media, 2021

Mbështjellëse dinamiti (*gjetur në një rënë prej galerive në minierën e Bulqizës*), llampë vajguri ndricuese, qafore për zbutje të qenve, tavolinë e vogël (*gjetur në një rënë nga shtëpitë e fshatit të braktisur Zogjaj, 28 km larg qytetit të Bulqizës*).

—
Dynamite wrapping papers (*found in one of the galleries of Bulqiza's mine*), kerosene lamp, collar for taming wild dogs, small table (*found in one of the houses of the abandoned village of Zogjaj, 28 km away from the town of Bulqiza*).



Collection of the Department of Anthropology, University of Cambridge, UK
The British Library, London, UK
The British Library, London, UK
The British Library, London, UK





që e gjen të keqen vetëm tek ne?! Mësohu t'i dalësh për zot vetes tënde!

Ergin Zaloshnja (EZ)

Diskutimi është i hapur. Edhe ne na kanë kërcënuar gjatë kohës së qëndrimit në Bulqizë.

AM

I hapur është diskutimi, po jo siç e bën ti!

ED

Ne jua shtruan disa herë pyetjen se përse ndodhi copëzimi në 42 kompani koncesionare i minierës së Bulqizës, që sot kanë dalë jashtë kontrollit të shtetit.

GM

Copëzimin e kanë kërkuar punëtorët vetë. Kjo ka të bëjë edhe me qeverisjen vendore. S'mund të ketë faj qeveria që ai atje sillet si gangster. Përndryshe kryetari i bashkisë duhet të njoftojë policinë.

ED

Ish-kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit bashkiak..., janë koncesionarë të disa galerive minerare, sot e kësaj dite.

EZ

Kjo është situata sot atje. Të vjen telefonata dhe të thonë: mos shko në minierë, se po sillesh shumë vërdallë, ose mos fotografo këtë pìrgun e kromit sepse më përket mua.

GM

Ju keni shkuar në një moment që ka ndodhur një aksident aty.

EZ

Aty ndodhin shumë shpesh aksidente.

Ergin Zaloshnja (EZ)

The discussion is open. We were also threatened during our stay in Bulqiza.

AM

The discussion is open, but not like you do it!

ED

We have asked you several times about the reason for the partition of the 42 concession-holding companies in Bulqiza, which today are entirely out of the state's control.

GM

It was the workers who demanded the partition, which also falls under the domain of the local government. The government is not responsible for someone acting like a gangster. In that case, the mayor should call the police.

ED

Former mayors, members of the municipal council, etc. — they are all concession holding of several mining galleries, to this day.

EZ

The situation there today is like this — you receive a phone call and the person on the other end of the line says: “Don't go to the mine; you're coming around too often.” Or: “Don't take a picture of this pile of chrome because it belongs to me.”

GM

You went there when an accident took place.

EZ

Accidents there are very frequent.

PXH

Ne kemi shkuar në fund të gushtit, dhe deri më sot kemi asistuar në katër aksidente me pasojë edhe vdekjen.

BH

Sidomos në këto minierat e vogla. Si ekzistojnë këto miniera?

GM

Shiko, ligjet në Shqipëri, në letër janë ndoshta më të mira se ligjet e Europës, problemi që kemi ne është në zbatimin e tyre. Që të zbatohet ligji, do të thotë që këto ndërmarrje të inspektohen, nga pikëpamja e sigurimit teknik dhe e kushteve të punës. Shteti ka një strukturë që quhet Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Ka persona që paguhen për inspektimin e minierave sipas një programi të caktuar. Nëse nuk zbatojnë kushtet teknike dhe rregullat, nuk iu rinovohet licenca. Por e thashë edhe një herë që zbatueshmëria e ligjit në Shqipëri është problem, dhe këtu dalim te qeverisja: nuk funksionojnë institucionet.

BA

Shpesh ka ndodhur që Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera të nxjerrë fajtor viktimën.

GM

Si është e vërteta?

BA

E vërteta është që punëtori ka marrë urdhër nga pronari për të punuar në një zonë të pasigurt. Përndryshe unë si punëtor nuk mund të futem me vullnetin tim në një zonë të rrezikshme.

GM

A ka dëshmitarë që pronari ka dhënë urdhër? Punëtorët, kushtet e sigurisë teknike, nuk i zbatojnë. Shiko, miniera do ketë aksidente

PXH

We went there at the end of August this year and, during that time, we assisted in four accidents, including fatal ones.

BH

This is especially the case in the small mines. How can these mines exist?

GM

Look, on paper, the laws in Albania are probably better than the laws of Europe. The problem lies in their implementation. Law enforcement means the inspection of these enterprises in terms of technical security and working conditions. The state has a structure called the National Agency of Natural Resources. There are people who get paid to inspect mines, according to specific programs. If the mines do not fulfill the technical conditions and regulations, their license will not be renewed. However, as I already mentioned, the problem in Albania is the implementation of the law, and here we come back to the question of governance — the institutions are not functional.

BA

Often, the National Mining Safety and Emergency Authority has found the victim guilty.

GM

And the truth is?

BA

The truth is that the worker obeys the orders of the owner to work in an unsafe area. Otherwise, as a worker, I would willingly never enter a dangerous area.

GM

Are there any witnesses that the owner issued the order? Workers do not comply with technical safety requirements. Look, accidents will always take place in the mine. Before, with 60,000 workers nationwide, there were very

gjithmonë. Dikur me 60 mijë punëtorë në rang republike kishte shumë pak aksidente. Sot nuk punojnë më shumë se 2 mijë...

BA

Edhe më pak.

ED

Rreth 620 punëtorë ka AlbChrome-i... Bardhul, rrugës për në minierë shikon çdo punëtor me qesen e bukës nën sqetull. Është diskutuar ndonjëherë që ushqimin ta paguajë kompania?

BA

Është një trajtim që na e përfshijnë në rrogën mujore.

GM

Ato lekë ata i çojnë te fëmijët. Minatori qumështin dhe antidotët, suplementet e tjera duhet t'i marrë aty në minierë, që të ketë efekt drejtëpërdrejt në shëndetin e tij, se ai po futet në nëntokë, jo fëmija i tij. Edhe kjo hyn te rregullat e sigurimit teknik.

VGO

Meqë jemi në fund të takimit. Kjo që ndodhi tani në fund, na tregon forcën e artit. Pasi kemi dëgjuar më shumë se 30 minuta retorikë politike, flet një artist një sekondë, përdoret një emër oligarku dhe politikani shpërthen emocionalisht dhe braktis diskutimin. Mendoj se kjo është një gjë fantastike, edhe poetike. (*Duartrokijtje në sallë.*) Edhe kjo na tregon potencialin e artistit të angazhuar, që interesohet vërtet për çfarë po ndodh në vendin e tij.

GM

Ky incident ishte arritje e këtij takimi.

VGO

few. Today, no more than two thousand work and...

BA

Even fewer.

ED

AlbChrome has about 620 workers... Bardhul, on the way to the mine, one sees that every worker carries a lunch bag. Has it ever been suggested that the company should pay for the food?

BA

It is included in our monthly wages.

GM

They give that money to their children. The mine worker should drink the milk, and take the antidote and supplements there, in the mine, so that they directly contribute to his health. After all, it is he who is going underground, not his child. This also falls under the guidelines of technical safety measures.

VGO

Since we have reached the end of the meeting: what happened now, at the end, illustrates the power of art. After listening to over thirty minutes of political rhetoric, an artist speaks for a second, the name of an oligarch is mentioned, and the politician has an emotional outburst and abandons the discussion. I think this is a fantastic thing, even poetic. (*Applause in the room.*) This incident also shows us the potential of the engaged artist, of one who is truly interested in what is happening in the country.

GM

This incident was the biggest success of this meeting.

VGO

Absolutely!

Absolutisht!

ED

Bardhul, tani që kryetari i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës u largua në emigrim, do të zhvilloni zgjedhje për kryetarin e ri?

BA

Po, së shpejti do kemi zgjedhje.

ED

Ky takim nën titullin “Plagët e burimit” përfundon këtu, duke shpresuar që aq sa u tha, të depërtojë në instancat vendimmarrëse që vërtet kanë në dorë fatin e këtij komuniteti me probleme të shtresëzuara në kohë.

ED

Bardhul, now that the president of the Trade Union of United Miners of Bulqiza emigrated, will you hold elections for the new president?

BA

Yes, we will have the elections soon.

ED

This meeting, entitled “The Wounds at the Source,” concludes here — with our hope that what has been said will reach the decision-making bodies that hold the fate of a community, plagued with problems for many generations, in their hands.

Foto-album
nga qëndrimi
në Bulqizë


Photo Album
from the Stay
in Bulqiza











Quebec, Kanada, 4 Shkurt, 1949

5.000 mijë minatorët e minierës së asbestit paralizuan punën e katër minierave dhe u ngritën në protestë kundër qeverisë dhe kompanisë Johns-Manville.

Kërkesat e tyre ishin; rritja e rrogës me 1\$ në ditë, 9 ditë të paguara pushimesh në vit, pensione, pjesëmarrje në manaxhimin e minierës nga ana e bashkimit të sindikatës, dhe investime në sistem për të kufizuar pluhurin e asbestit që shkakton sëmundje pneumonare deri në kancer të mushkrive.

Një muaj nga fillimi i protestës në 14, mars 1949, përplasja mes protestuesve dhe policisë degjeneroi në dhunë.

Minatorët protestues krijuan barrikada për ta ndaluar futjen në punë të punëtorëve zëvendësues. Ata shpërthyen hekurudhat e galerive dhe rrahën një prej drejtuesve të minierës.

Me gjithë përpjekjet e kompanisë për ta ndaluar protestën, minatorët vijuan dhe më 5, maj, 1949 ata u përleshën sërish me policinë duke rrahur dhe çarmatosur një dyzinë policësh. Në ditët në vijim dhuna e ushtruar nga ana e policisë ishte aq e madhe sa tërhoqi vëmendjen e mediave botërore.

Në 1 Korrik 1949, pas një negociate të gjatë u arrit një marrëveshje me rritje 5% të rrogës, ndërsa problem i sëmundjeve të mushkrive nga pluhuri i asbestiti nuk u zgjidh. Megjithatë, kjo protestë i hapi rrugën asaj që njihet si "Revolucioni i Heshtur" që prodhoi ndryshime shumë të mëdha për të drejtat e punëtorëve në Kanada.

Silver City, New Mexico, tetor 1950 – janar 1952

Për t'i dhënë fund diskriminimit racial përmes rrogës punëtorët meksikan të minierës së zinkut Empire Zinc, u hodhën në protestë.

Kërkesat e tyre ishin; t'i jepej fund sjelljeve diskriminuuese në ambientet e punës dhe të hiqej sistemi i dyzuar i rrogave, ku punëtorët meksikan merrni sa gjysma e rrogës së atyre amerikan.

Minatorët meksikanë u vendosën në dyert e minierës duke bllokuar punën e saj për tetë muaj, ata qëndruan aty ditë – natë pa ndërprerje.

Në qershor të viti 1951 për të ndaluar protestën, gjykata e rajonit të New Mexico-s vendosi një sanksion me burgim për minatorët që vijonin protestën. Kështu për të evituar burgun bashkëshortet e minatorëve iu bashkuan protestës së bashku me fëmijët.

Megjithëse ato nuk i kapte sanksioni, policia lokale ushtronte dhunë sistematike mbi gratë protestuese, të cilat përfundonin në spital për shkak të plagëve të marra nga mjetet e forta dhe armët e zjarrit.

Lajmet e këtyre akteve nga ana e policisë u përhapën në qytetet pranë minierës dhe shumë minatorë të zonave përreth iu bashkuan protestës.

Më 21 janar, 1952, kompania Empire Zinc, iu ofrua minatorëve me një marrëveshje që plotësonte kërkesat për sjellje dhe rroga të barabarta dhe po ashtu kompania ndërtoi edhe impante për të furnizuar qytetin me ujë të pijshëm.

Një vit më vonë në 1953, një grup kineastësh shkuan në Silver City për të realizuar një film për këtë protestë dhe aktorët që interpretuan në të ishin pjesëmarrësit e vërtetë të protestës. Ky film u censurua për disa vite në SHBA, por aktivistët e të drejtave të njeriut nga Chicano arritën ta shpërndanin dhe më vonë në 1992 filmi u vendos në filmografinë e Kongresit për shkak të rëndësisë historike mbi të drejtat e minatorëve.



1
1
0



1
1
1



1
1
2









1
1
6

Ne përnad xhafa: Diana Malaj,
ERGIN ZALOSHINI, BLEETA
HOGIA, po e marrim për të bërë
- t kamizen me qullim për
to për dorë si destinimi e
~~ose~~ e braktisjes së fjalës
të tyre.

Me respekt

P. XH

D. M

E. Z

B. H





POLITIKAT MINERALE

Rezidencë artistike në qytetin e Bulqizës,
Verë 2021

MINERAL POLICIES

Art Residency in the city of Bulqiza,
Summer 2021

Të drejta e autorit © 2022
nga redaktorët dhe autorët.

Copyright © 2022 by the editors and authors. This work carries a Creative Commons BY-NC-SA 4.0 International license, which means that you are free to copy and redistribute the material in any medium or format, and you may also remix, transform and build upon the material, as long as you clearly attribute the work to the authors (but not in a way that suggests the authors or punctum books endorses you and your work), you do not use this work for commercial gain in any form whatsoever, and that for any remixing and transformation, you distribute your rebuild under the same license. <http://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/>



Botuar në 2022 nga Qendra e Artit
Bashkëkohor ZETA
Rr. Abdyl Frashëri, Nd.8, H.7, Ap.4,
1019 Tiranë, Shqipëri në bashkëpunim me
Departamentin e Shqiponjave / punctum
books, Toka, Kashta e Kumtit.
<https://punctumbooks.com>

Published in 2022 by ZETA
Contemporary Art Center
Rr. Abdyl Frashëri, Nd.8, H.7, Ap.4,
1019 Tirana, Albania in collaboration with
the Department of Eagles, an imprint of
punctum books, Earth, Milky Way.
<https://punctumbooks.com>

ISBN-13: 978-1-68571-074-3 (print)
ISBN-13: 978-1-68571-075-0 (ePDF)
DOI: 10.53288/0443.1.00
LCCN: 2022934325

Drejtor i projektit
Project Director

Valentina Koça

Mbikëqyrja dhe lehtësimi
Supervision & Facilitation

Kleidi Eski

Redaktor
Editor

Marko Stamenkoviç

Folësit e ftuar
Guest Speakers

Bardhul Alla
Arben Malaj
Vincent W.J. van Gerven Oei
Genc Myftiu
Elsa Demo

Transkripti
Transcription

Elsa Demo

Përkthimi
Translation

Jora Vaso
Ilirjana Stringa

Ekspozita

Exhibition

Each Strike Leads to the Next

Artistët pjesëmarrës

Participating Artists

Diana Malaj

Blerta Hoçia

Pleurad Xhafa

Ergin Zaloshnja

Kurator i ekspozitës

Exhibition Curator

Vincent W.J. van Gerven Oei

Koordinator i ekspozitës

Exhibition Coordinator

Evelina Sota

Menaxhimi teknik

Technical Management

Andon Ikonomi

Dokumentimi

Media Documentation

Mrinë Godanca

Pleurad Xhafa

Fotografi nga:

Photo Credits:

© ZETA: 18, 28, 37, 52, 56, 61, 101

© Mrinë Godanca: 76–77, 78, 79, 80–81,
82–83, 84–85, 86–87, 88, 89,

© Artists: 24–25, 38–39, 54–55, 72–73,
74–75, 95, 96, 97, 98–99, 100, 101, 102,
103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110,
111

Dizajni grafik

Graphic Layout & Design

Kavalo Studio

Lloji i shkrimit

Typeface

Helvetica Regular-Bold

Falenderime

Special thanks to

Endri Dani

Elton Debreshi

Jonida Gashi

Raino Isto

Genc Myftiu

Anita Shushku

Enkelejda Stefani

Ky katalog është botuar ne kontekstin e projektit POLITIKAT MINERALE - Rezidencë Arti, organizuar nga Qendra e Artit Bashkëkohor ZETA gjatë verës 2021, në Bulqizë dhe Tiranë. Ky projekt mbështetet nga Fondi Kulturor Zviceran, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Qendra për Biznes, Teknologji dhe Lidership (CBTL).

This catalogue is published on the occasion of the MINERAL POLICIES – Art Residency, organized by ZETA Contemporary Art Center during the Summer 2021, in Bulqiza and Tirana, supported by Swiss Cultural Fund in Albania (SCFA), a project of the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC).



Një minatori nga qyteti i Bulqizës iu kerkua që mbi një kopertinë të bardhë të inskenojë me duar pozicionin e betimit për t'u rrëfyer me vërtetësi në përmbajtjen e vetë librit. Nga ky proces përftohet gjurma e shtresës së kromit mbas përfundimit të ditës së punës në minierë.

A miner from Bulqiza was asked to perform the gesture of taking an oath on the contents of the book itself. From this process, the layer of chrome dust resulting from a day of work was collected as the image on the cover.